

# RAPORT VJETOR

---

## 2013

“Mbi Aktivitetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”



**Adresa:**

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Rruga e Durrësit, nr. 83 Tiranë

Centrali: +355 4 2 235 622, +355 4 2 227 198

Cel: 0682059077, 0692075088

[kontakt@iss.gov.al](mailto:kontakt@iss.gov.al)

## PËRMBAJTJE

- Mesazh përshëndetës i Drejtores së Përgjithshme të ISSH-së
- Profil i Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Këshilli Administrativ i ISSH-së
- Struktura Administrative e Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Legjislacioni
- Marrëdhënie ndërkombëtare
- Përfitime
- Kontribute
- Zhvillimi i burimeve të informacionit
- Arkivi Qendror i Sigurimeve Shoqërore
- Aktiviteti financiar
- Administrimi i burimeve njerëzore dhe investime
- Informimi dhe marrëdhëniet me publikun
- Statistika të sigurimeve shoqërore

## MESAZH PËRSHËNETËS I DREJTORES SË PËRGJITHSHME TË ISSH-së



Zbatimi me rigorozitet i legjislacionit dhe fokusimi në drejtim të një shërbimi më cilësor për publikun, kanë qenë kryefjala e punës së stafit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2013. Hapat e hedhur për informatizimin e sistemit, realizimin e planit të të ardhurave, si dhe pastrimin e skemës së sigurimeve shoqërore nga përfitimet e pamerituara, kanë bërë të mundur afrimin e mëtejshëm me bashkëqytetarët, në respekt të çdo përfitimi të marrë dhe kontributi të derdhur prej tyre.

Përfundimi i Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore dhe vënia e tij në funksion të plotë ka qenë një nga arritjet më të mëdha të institucionit tonë për këtë vit. Ky Arkiv, i ndërtuar me fondet e Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore, në kuadër të kredisë së dhënë për modernizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, është unik dhe modern, si për ambientet dhe pajisjet, ashtu dhe për volumin e madh të punës që realizon çdo ditë. Rëndësia e tij qëndron në arkivimin e të gjithë dokumentacionit të historikut kontributiv të të gjithë shtetasve, jo vetëm në letër, por edhe në formë dixhitale. Ky proces, i cili ka nisur me grumbullimin,

skanimin dhe dixhitalizimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë, ka mundësuar krijimin e arkivit dixhital me llogaritë individuale kontributive të çdo pjesëmarrësi në sistemin e sigurimeve shoqërore, si dhe shfrytëzimin e tij për lidhjen e të gjitha llojeve të përfitimeve që ne ofrojmë. Gjithashtu, krahas dixhitalizimit të regjistrave të punës të ish-kooperativave bujqësore, është realizuar dixhitalizimi i pjesës më të madhe të regjistrave të ish-ndërmarrjeve shtetërore, deri në vitin 1994, si dhe është përgatitur dokumentacioni i kontributeve pas vitit 1994. Falë punës në Arkivin Qendror të Sigurimeve Shoqërore, ne po konsolidojmë transparencën ndaj kontribuesve, ofrojmë shërbim më të shpejtë dhe më cilësor për qytetarët, bëjmë llogaritje automatike të përfitimeve, mirëadministrojmë fondet dhe vazhdojmë të krijojmë një bazë shumë të sigurtë e të dobishme të dhënash, e cila në të ardhmen, do të shfrytëzohet me efikasitet për studime të ndryshme që mund të realizohen, në lidhje me reformimin e skemës së pensioneve.

Paralelisht me punën për vënien në funksion të Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, gjatë vitit 2013, u përmirësuan ndjeshëm proceset teknologjike të sistemit të sigurimeve shoqërore, nëpërmjet zbatimit të disa programeve të reja informatike, siç janë: programi për hedhjen online të të dhënave të dosjeve të pensioneve ekzistuese, programi për sistemin financiar të informatizuar, programi i menaxhimit të kontributeve, si dhe programi i llogaritjes automatike të përfitimeve. Në kuadër të informatizimit të sistemit, edhe të dhënat e arkivit dixhital do të përdoren për llogaritjen e përfitimeve në kohë.

Një arritje për t'u theksuar është krijimi i Regjistrat Kombëtar Elektronik të Pensioneve dhe realizimi i pagesave të pensioneve nëpërmjet portalit elektronik online. Futja e këtij procesi të ri teknologjik në sistemin e sigurimeve shoqërore ka bërë të mundur rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pensionistëve, rritjen e transparencës për masën e pensioneve dhe të kompensimeve që jepen nga Qeveria, përmirësimin e kontrollit të pagesave dhe shmangien e abuzimeve që rrjedhin prej tyre, si dhe mirëadministrimin e fondeve që menaxhohen nga ISSH.

Për realizimin me efektivitet të të gjithë punës tonë, sistemi i sigurimeve shoqërore është i lidhur, në mënyrë interaktive, nëpërmjet rrjetit GovNet, me sisteme të tjera të administratës publike si: Gjendja Civile, Posta Shqiptare sh.a, Autoriteti Tatimor etj. Të gjitha të dhënat, në lidhje me gjeneralitetet e një personi, merren saktësisht online nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, çka po na ndihmon shumë në angazhimin tonë për pastrimin e skemës nga përfitimet e pamerituara.

ISSH ka vijuar të ketë në fokus të punës së saj intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, me qëllim që të jetë pranë çdo shtetasi shqiptar, kudo që ai jeton dhe punon, duke marrë pjesë e kontribuar në proceset negociatore për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale, në fushën e mbrojtjes sociale. Kanadaja, Çekia, Maqedonia, Luksemburgu dhe Belgjika kanë qenë pesë shtetet, të cilat gjatë vitit 2013 kanë çuar më tej apo përmbyllur marrëveshjet, duke rritur hapësirat ligjore dhe administrative për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë dhe për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me ato të BE-së, si rrjedhojë e detyrimeve që vijnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në.

Unë dhe stafi që drejtoj jemi të bindur se aktiviteti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore prek çdo familje shqiptare, ndaj dhe përmirësimi i vazhdueshëm i punës sonë duhet të ndjehet në përditshmërinë e bashkëqytetarëve tanë. Mbështetur në këtë fakt, ISSH ka vijuar të krijojë hapësira të reja komunikimi, duke besuar se bashkëpunimi me çdo kontribues e përfitues e bën më të lehtë arritjen e objektivave të saj. Në faqen tonë zyrtare [www.iss.gov.al](http://www.iss.gov.al), gjatë vitit 2013, krijuam dy rubrika të rëndësishme: Pyesni online dhe Denonco online, nëpërmjet të cilave të gjithë ata që kërkonin informacion apo duhej të denonconin parregullsitë dhe pakënaqësitë, lidhur me funksionimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, mund t'i realizonin ato në mënyrë elektronike. Këto dy shërbime kanë krijuar një sërë lehtësirash për qytetarët që jetojnë brenda dhe jashtë vendit, duke shmangur përdorimin e shërbimit postar ose paraqitjen e tyre personalisht pranë zyrave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pasi për çdo pyetje apo ankesë që na drejtohet, stafi ynë kthen përgjigje në kohë.

Të nderuar lexues, shpresojmë që me anë të këtij Raporti Vjetor, t'ju kemi ofruar të gjithë informacionin e nevojshëm për ecurinë e sistemit të sigurimeve shoqërore gjatë vitit 2013.

**Vjollca BRAHO**


**DREJTORE E PËRGJITHSHME E ISSH-së**



## PROFILI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion që realizon të drejtën e shtetasve për mbrojtje shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Ai u krijua në Qershor të vitit 1992, me Vendim të Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>, për të administruar sistemin e sigurimeve shoqërore. Skema aktuale e sigurimeve të detyrueshme shoqërore në Shqipëri filloi në vitin 1993 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”<sup>2</sup>. Ajo është një skemë jo fitimprurëse, e ndërtuar mbi parimin “pay-as-you go”, parimin e vetëpërgjegjësisë së individit për rreziqet e së ardhmes dhe parimin e solidaritetit midis brezave.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, shtetëror e i pavarur dhe drejtohet nga një Këshill Administrativ tripalësh, me përfaqësues të Qeverisë<sup>3</sup>, të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Aktivitetin e tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore e realizon nëpërmjet zyrave rajonale dhe agjensive lokale, që shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë.



1. VKM nr. 249, datë 5.6.1992 “Për krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

2. Ligji hyri në fuqi më 1 Tetor 1993.

3. Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Statistikave

## KËSHILLI ADMINISTRATIV I ISSH-së

### Kryetar

**Ridvan BODE**

- Ministër i Financave

### Nënkryetarë

**Gëzim KALAJA**

- President i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë

**Ismail VAROSHI**

- Përfaqësues i Konfederatës së Organizatave të Punëdhënësve

### Anëtarë

**Kastriot SULKA**

- Zv/Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale

**Elvana HANA**

- Drejtore e Përgjithshme, ISKSH

**Ines NURJA**

- Drejtore e Përgjithshme, INSTAT

**Ylli DYLGJERI**

- Drejtor, Ministria e Ekonomisë

**Ermira SHTINO**

- Drejtore, Ministria e Drejtësisë

**Avenir KIKA**

- Përfaqësues i Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë

**Eshtem GRACI**

- Përfaqësues i Unionit të Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë

**Kolë NIKOLLAJ**

- Përfaqësues i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë

**Bashkim SALA**

- Përfaqësues i Bashkimit të Organizatave të Biznesit Shqiptar

## ANËTARËT E BORDIT DREJTUES TË ISSH-së

**Vjollca BRAHO**

- Drejtore e Përgjithshme

**Ali EMINI**

- Zv/Drejtor i Përgjithshëm

**Astrit HADO**

- Zv/Drejtor i Përgjithshëm

**Hasan HOXHA**

- Zv/Drejtor i Përgjithshëm

**Teuta MUÇO**

- Drejtore e Drejtorisë së Kontributeve

**Sabah GOCI**

- Drejtor i Drejtorisë së Përfitimeve

**Kreshnik BRASHA**

- Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

**Elvin NURIU**

- Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm

**Lindita GJINAJ**

- Drejtore e Drejtorisë së Financës

**Agim BAÇI**

- Drejtor i Drejtorisë së Statistikës & Marrëdhënieve me Publikun


**Mirela SELITA**

- Drejtore e Drejtorisë Juridike





## STRUKTURA ORGANIZATIVE E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE



## LEGJISLACIONI

### Vendime të Këshillit të Ministrave:

#### Në fushën e kontributeve

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1114, datë 30.07.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Paga minimale dhe maksimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në zbatim të këtij Vendimi, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 30.07.2013, duke filluar nga data 1 gusht 2013, është 19.026 lekë, ndërsa paga maksimale mujore 95.130 lekë. Gjithashtu, ky Vendim, përcaktoi masën e pensionit bazë në qytet 12, 024 lekë në muaj dhe masën e pensionit bazë në fshat 8,233 lekë në muaj. Masa e pensionit maksimal në qytet u caktua 24,048 lekë në muaj dhe pensioni maksimal në fshat 12,140 lekë në muaj.



#### Në fushën e përfitimeve

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 17.07.2013 “Përcaktimi i koeficientit të indeksimit të bazës individuale të vlerësueshme për llogaritjen fillestare të masës së pensionit”. Ky Vendim përcaktoi koeficientin e bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, si rrjedhojë e kontributeve të mbledhura një vit më parë.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 583, datë 17.07.2013 “Për rritjen e pensioneve”. Në bazë të këtij Vendimi, përfituan rritje në masën 4% pensionet e pleqërisë: familjare dhe të invaliditetit të qytetit, në masën 5% pensionet e pleqërisë: ato familjare dhe të invaliditetit në fshat, rritjen me 4% dhe të pensioneve apo përfitimeve të tjera që jepen nga sigurimet shoqërore, si pensionet e parakohëshme, përfitimet suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të policisë së shtetit, të pilotëve fluturues, të detarëve, të punonjësve të ndërmarrjeve ushtarake dhe të ish-punonjësve të nëntokës etj.

## MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE



Mirela SELITA  
Drejtoresh, Drejtoria Ligjore

Sigurimet shoqërore janë mbrojtje e bazuar në aktivitetin profesional, që do të thotë se çdo person që është i punësuar, i vetëpunësuar ose punëdhënës është i detyruar të sigurohet dhe në përfundim, e drejta për pension i lind vetëm nëse ka arritur një periudhë kualifikuese. Shpesh, periudha kualifikuese për lindjen e të drejtës për përfitim nga sigurimet shoqërore, bëhet pengesë për personat që lëvizin dhe punojnë në vende të ndryshme. Pikërisht, këto pengesa zgjidhen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe mes vendit të origjinës dhe vendit pritës. Marrëveshjet dypalëshe, si marrëveshje koordinuese të skemave të sigurimeve shoqërore përbëjnë instrumentin ligjor, që garanton të drejtat e qytetarëve në rastet e lëvizjes nga një vend në tjetrin dhe njohjen e respektimin e të drejtave për sigurime shoqërore të akumuluar në vite.

Gjatë viti 2013, koordinimi i skemës shqiptare të sigurimeve shoqërore me skemat evropiane ishte objektiv dhe detyrim, në zbatim kjo të neneve 48 dhe 99 të Marrëveshjes të Stabilizim–Asociimit dhe Rekomandimeve, në vijim të takimeve të Komitetit dhe Nënkomitetit të Bashkimit Evropian - Shqipëri për “Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale”.

Rritja e hapësirës ligjore dhe administrative për mbrojtjen dhe mbulimin e emigrantëve nga skema e sigurimeve shoqërore përmes nxitjes dhe intensifikimit të punës për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mbrojtjes shoqërore, vijoi të ishte një objektiv i rëndësishëm për ISSH-në gjatë vitit 2013.

Për realizimin e këtyre objektivave, gjatë vitit 2013, Instituti i Sigurimeve Shoqërore zhvilloi, në kuadër të grupit negociator (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor) disa raunde bisedimesh me një sërë shtetesh, për realizimin e Marrëveshjeve Bilaterale në fushën e mbrojtjes shoqërore, dhe të Marrëveshjeve Administrative për zbatimin e tyre, si më poshtë vijon:

- Në datat 28 Janar - 02 Shkurt 2013, në Bruksel, u zhvilluan bisedimet për realizimin e marrëveshjes administrative, për zbatimin e marrëveshjes së përfunduar, të mbrojtjes shoqërore, midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës. Sipas procedurave, marrëveshja kuadër, shoqërohet me marrëveshjen administrative dhe me formularët, me qëllim që rregullat për të cilat është rënë dakort në marrëveshjen bazë, të bëhen të zbatueshme në praktikë, për qytetarët e të dy vendeve. Objekt i diskutimeve ishte drafti i procedurave administrative të propozuara nga pala Belge, i cili si rrjedhojë e bisedimeve u përmirësua duke pasqyruar në të edhe propozimet e palës shqiptare, të cilat mbështeteshin si në standartet në këtë fushë, ashtu edhe në legjislationin tonë të brendshëm;
- Në datat 11 - 13 Mars, 2013, në Shkup, u zhvillua raundi i tretë i bisedimeve për realizimin e një marrëveshjeje për mbrojtjen shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë. Përveç parimit të bashkimit të periudhave të sigurimit, parim tjetër i rëndësishëm i marrëveshjeve është ai i trajtimit të barabartë të qytetarëve të të dy shteteve, reciprokisht. Tek marrëveshjet bilaterale me shumë interes për qytetarët, është edhe klauzola sipas të cilës një ankesë konsiderohet e dorëzuar në afat në institucionin e një vendi me të cilën Shqipëria ka marrëveshje, edhe kur paraqitet brenda të njëjtit afat në Shqipëri. Pra, nëse shtetasi shqiptar dorëzon në institucionin homolog të pensioneve të Maqedonisë, një ankesë që duhet të dorëzohet në institucionin shqiptar të pensioneve, ajo konsiderohet si e dorëzuar në Shqipëri;
- Nga data 09 - 12 Prill 2013, në Tiranë, u zhvillua raundi i dytë i negociatave për lidhjen e Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë. Objekti ligjor i draftmarrëveshjes Shqipëri – Çeki, ishte legjislationi në lidhje me skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe legjislationi për skemën e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore. Në kuadër të standarteve në fushën e marrëveshjeve bilaterale, edhe në këtë marrëveshje u ra dakort për njohjen e dyanshme të

periudhave të sigurimit, periudhave të punës, periudhave kontributeve, si edhe të gjithë atyre periudhave që legjislacioni çek e shqiptar i ka njohur si ekuivalente me to, p.sh. koha gjatë së cilës është kryer shërbimi ushtarak, ose periudha e pagesës së papunësisë, pagesës së asistencës etj;

- Nga data 10 - 13 Shtator 2013, në Tiranë, u zhvillua raundi i dytë i negociatave për diskutimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut. ISSH negocioi dispozitat e projekt-marrëveshjes për pensionet. Në lidhje me fushën e pensioneve, themeli i kësaj marrëveshjeje ishte bashkimi i periudhave të punës dhe periudhave të sigurimit të realizuara në të dy vendet Shqipëri dhe Luksemburg, me qëllim lindjen e të drejtës për pension (pension pleqërie, invaliditeti apo familjar). Për shembull një shtetas shqiptar, i cili ka punuar në Shqipëri 10 vite dhe në Luksemburg 7 vite, dhe ka mbushur moshën 65 vjeç, aplikon për pension në Shqipëri. Si rrjedhojë e zbatimit të marrëveshjes dypalëshe, atij i bashkohet periudha e punës në Shqipëri me periudhën e punës/sigurimit në Luksemburg, e në këtë mënyrë ai fiton të drejtën për një pension. Në përfundim, secili prej dy shteteve, Shqipëria dhe Luksemburgu do të paguajnë pjesën respektive të pensionit, në raport me kohën e punuar dhe për të cilën janë paguar kontributet (në gjuhën teknike kjo formulë njihet si formula “pro-rata”, pra llogaritja përpjestimore);

- Në datat 7 - 8 Tetor 2013, në Tiranë, u zhvillua takimi i parë i negociatave për marrëveshjen dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Kanadasë dhe Shqipërisë. Në këtë raund të parë bisedimesh, u diskutua në parim teksti i projekt-marrëveshjes së propozuar nga ana e palës kanadeze. Përfitimet e sigurimeve shëndetësore në këtë marrëveshje nuk përfshihen, pasi sistemi i sigurimit shëndetësor në Kanada është i organizuar në bazë të provincave dhe jo nën përgjegjësinë e Qeverisë Federale. Të dy delegacionet, kanadez dhe shqiptar prezantuan sistemet e tyre të mbrojtjes sociale, shkëmbyen informacionet mbi legjislacionet e tyre kombëtare. Me shumë interes ishin të dhënat mbi programin e Sigurimit të Kanadasë për të moshuarit, të dhënat mbi Planin e Pensionit të Kanadasë, si dhe mbi Marrëveshjet e Sigurimeve Shoqërore që Kanadaja ka me vendet e tjera;



- Në muajin Nëntor të vitit 2013, ISSH në kuadër të plotësimit të detyrimeve për raportim mbi “Paktin e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”, pranë Komitetit përkatës (CESCR) në Gjenevë, përgatiti materialin mbi pyetjet e takimit të fundit të këtij Komiteti;
- Në datat 28-29 Nëntor 2013, ISSH në përmbushje të detyrave të caktuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit BE - Shqipëri, përsa i takon marrëdhënieve me BE-në, mori pjesë në Takimin e Pestë të Nënkomitetit për “Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale”, për të raportuar mbi “Situatën në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore”.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2013, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka vijuar punën për zbatimin e Marrëveshjes së Mbrojtjes Shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, (hyrë në fuqi në datë 15.04.2005), duke realizuar të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe turq për njohjen e bashkimit të periudhave të kontribuimit të sigurimeve shoqërore në të dy vendet. Në total nga koha e hyrjes në fuqi të marrëveshjes janë realizuar 550 procedura në zbatim të saj;



## PËRFITIME



Sabah GOCI  
Drejtor, Drejtoria e Përfitimeve


Sistemi aktual i pensioneve në Shqipëri mbështetet në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993: "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe ngrihet mbi dy kolona: në atë të detyrueshme dhe kolonën suplementare, që aktualisht mbetet akoma e pazhvilluar. Kolona e sigurimit të detyrueshëm mbulon të punësuarit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë. Periudha e sigurimit hyn në fuqi në momentin kur personi fillon ligjërisht aktivitetin ekonomik dhe mbaron kur e mbyll atë. Për të fituar të drejtën e pensionit, personat detyrimisht duhet të kontribuojnë në degën përkatëse për një periudhë sigurimi, që përfshin kohën kur janë derdhur kontributet në skemën e sigurimeve shoqërore. Përfitimet nga skema e sigurimeve shoqërore, sipas kohëzgjatjes së tyre ndahen në:

### A Përfitime afatgjata

Periudha e dhënies së këtyre përfitimeve zgjat mbi 1 vit. Në këto kategori përfitimesh përfshihen pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare. Aktualisht, skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore vazhdon të trajtojë pensionet urbane dhe pensionet rurale<sup>1</sup>, këto të fundit me tendencë uljeje në numër.

Për vitin 2013, në këtë skemë janë trajtuar me përfitime afatgjata të të gjitha llojeve 570,423 persona, nga këto 418,399 pensione urbane dhe 152,024 pensione rurale.

- Pensionet e pleqërisë përbëjnë grupin më të madh të përfituesve, me rreth 78.4% të tyre, ose 447,286 pensione, duke përfshirë të dy llojet e pensioneve urbane dhe rurale, prej të cilëve 311,382 pensione pleqërie urbane dhe 135,904 pensione pleqërie rurale;
- Pensionet e invaliditetit zenë rreth 11,7% të pensioneve gjithsej, ose 66,470 persona, prej të cilëve 59,241 invalidë urbanë dhe 7,229 invalidë ruralë;
- Pensionet familjare përbëjnë 9.9% të pensioneve gjithsej ose 56,667 pensione, prej të cilave 47,776 pensione familjare urbane dhe 8,891 pensione familjare rurale.



Gjatë vitit 2013 në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore janë lidhur në total 36,049 pensione të reja, nga të cilat 26,151 pensione pleqërie, 7,076 pensione invaliditeti dhe 2,822 pensione familjare. Gjithashtu është punuar në drejtim të përmirësimit të punës përsa i përket respektimit të afateve të caktimit të pensioneve.



### Treguesit e afateve në lidhjen e pensioneve për vitin 2013

| Drejtoria<br>Rajonale | Nr. pensione<br>të reja | Ditë mesatare për pension |           |           |           | Përqindja e pensioneve të lidhura në afat |           |           |           |
|-----------------------|-------------------------|---------------------------|-----------|-----------|-----------|-------------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
|                       |                         | Total                     | Pleqëri   | Invalide  | Familjare | Total                                     | Pleqëri   | Invalide  | Familjare |
| Berat                 | 1,964                   | 24                        | 20        | 12        | 19        | 97                                        | 98        | 86        | 99        |
| Dibër                 | 1,289                   | 27                        | 25        | 48        | 22        | 84                                        | 89        | 76        | 73        |
| Durrës                | 2,995                   | 127                       | 46        | 34        | 38        | 21                                        | 25        | 6         | 22        |
| Elbasan               | 3,682                   | 21                        | 23        | 45        | 21        | 97                                        | 99        | 91        | 99        |
| Fier                  | 4,570                   | 27                        | 22        | 53        | 18        | 94                                        | 99        | 63        | 98        |
| Gjirokastrë           | 1,549                   | 17                        | 23        | 58        | 23        | 99                                        | 99        | 99        | 99        |
| Korçë                 | 3,363                   | 30                        | 16        | 29        | 19        | 92                                        | 96        | 77        | 95        |
| Kukës                 | 717                     | 27                        | 32        | 32        | 23        | 98                                        | 98        | 98        | 98        |
| Lezhë                 | 1,662                   | 30                        | 23        | 32        | 23        | 91                                        | 91        | 91        | 98        |
| Shkodër               | 2,716                   | 24                        | 31        | 33        | 29        | 95                                        | 96        | 94        | 93        |
| Tiranë                | 8,176                   | 53                        | 46        | 81        | 54        | 55                                        | 63        | 18        | 58        |
| Vlorë                 | 3,366                   | 14                        | 20        | 24        | 21        | 98                                        | 98        | 98        | 99        |
| <b>Totali</b>         | <b>36,049</b>           | <b>39</b>                 | <b>29</b> | <b>46</b> | <b>30</b> | <b>79</b>                                 | <b>83</b> | <b>65</b> | <b>79</b> |

Në kuadër të informatizimit të procedurave për lidhjen e përfitimeve, në vitin 2013, u implementua në dy Agjenci Lokale të Sigurimeve Shoqërore në Fier dhe Vlorë, “Projekti pilot”, i programit të kalkulimit online të përfitimeve. Për aplikimin me sukses të këtij programi u realizua trajnimi i stafit të këtyre dy Agjencive. Ky program solli një sërë lehtësirash për të gjithë qytetarët të cilët aplikuan në sistem, duke mundësuar lidhjen e përfitimit në një kohë shumë të shkurtër, llogaritjen e pensioneve me saktësi maksimale, si dhe eliminimin e çdo lloj dyshimi dhe paqartësie në lidhje me masën e përfitimit. Nëpërmjet tij, deri në fund të vitit 2013, aplikuan në total 2,906 qytetarë në Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Fier dhe Vlorë.



Në vijim të punës së nisur gjatë vitit 2012, për informatizimin e pagesave online, u bë e mundur që në fillim të vitit 2013 të realizohej procedura e pagesës online të përfitimeve në 46 qendra paguese, në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat, Durrës, Fier, Korçë, Kukës, Vlorë dhe Tiranë. Në fund të vitit 2013 rreth 315,000 përfitues kishin akses për të përfituar këtë shërbim të ri nga sistemi online i sigurimeve shoqërore me një total prej 1,949,044 pagesash. Ofrimi i këtij shërbimi për qytetarët ka rritur transparencën, duke i dhënë mundësi atyre që të kenë informacion të detajuar mbi masën e të ardhurave. Gjithashtu aplikimi i këtij sistemi ka sjellë eliminimin e rradhëve të qytetarëve që presin të tërheqin pensionin e tyre pranë sporteve paguese të Postës Shqiptare sh.a, duke iu ofruar shërbim të shpejtë dhe të sigurtë.

## Politikat e zbatuara në fushën e pensioneve për vitin 2013

Gjatë vitit 2013, në zbatim të programit të Qeverisë për përmirësimin e nivelit të jetesës së pensionistëve, me VKM nr. 583, datë 17.07.2013 “Për rritjen e pensioneve”, masa mujore dhe të ardhurat mujore të pensionistëve u rritën si më poshtë:

- 4% pensionet urbane të pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare;
- 5% pensionet rurale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare;
- 4% pensionet suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të shkollave të larta e institucioneve kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë;
- 4% trajtimet e veçanta të minatorëve të nëntokës, punonjësve të ndërmarrjeve ushtarake.

Nga ky Vendim përfituan rreth 561 mijë pensionistë dhe rreth 30 mijë përfitues të trajtimeve të veçanta e të përfitimeve suplementare, me një efekt financiar vjetor prej 1,411 milionë lekësh. Edhe për vitin 2013, rritja vjetore e pensioneve ka qenë më e lartë se inflacioni.

Pensioni dhe të ardhurat minimale dhe maksimale të pleqërisë, si dhe kompensimet që kanë përfituar pensionistët, sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për vitet 2006 - 2013


|                                           | 2006   | 2007   | 2008   | 2009   | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   |
|-------------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat minimale për pensionet urbane | 10,000 | 10,410 | 11,275 | 12,226 | 12,840 | 13,267 | 13,712 | 14,174 |
| Pensioni minimal i pleqërisë urbane       | 8,240  | 8,650  | 9,515  | 10,276 | 10,690 | 11,117 | 11,562 | 12,024 |
| Kompensimi i energjisë elektrike          | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    |
| Kompensimi i bukës                        | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    |
| Kompensimi VKM nr. 401                    | 500    | 500    | 500    | 500    | 500    | 500    | 500    | 500    |
| Kompensimi VKM nr. 763                    | 760    | 760    | 760    | 760    | 760    | 760    | 760    | 760    |
| Kompensimi VKM nr. 415                    |        |        |        | 190    | 190    | 190    | 190    | 190    |
| Kompensimi VKM nr. 474                    |        |        |        |        | 200    | 200    | 200    | 200    |

|                                            | 2006   | 2007   | 2008   | 2009   | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   |
|--------------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat maksimale për pensionet urbane | 16,980 | 17,800 | 19,530 | 21,052 | 21,880 | 22,734 | 23,624 | 24,548 |
| Pensioni maksimal i pleqërisë urbane       | 16,480 | 17,300 | 19,030 | 20,552 | 21,380 | 22,234 | 23,124 | 24,048 |
| Kompensimi i energjisë elektrike           | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    | 350    |
| Kompensimi i bukës                         | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    | 150    |

|                                           | 2006  | 2007  | 2008  | 2009  | 2010  | 2011  | 2012  | 2013  |
|-------------------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Të ardhurat minimale për pensionet rurale | 4,310 | 5,410 | 6,090 | 7,234 | 7,870 | 8,358 | 8,731 | 9,123 |
| Pensioni minimal i pleqërisë Rural        | 4,110 | 4,520 | 5,200 | 6,344 | 6,980 | 7,468 | 7,841 | 8,233 |
| Kompensimi i energjisë elektrike          | 200   | 200   | 200   | 200   | 200   | 200   | 200   | 200   |
| Kompensimi VKM nr. 17                     |       | 690   | 690   | 690   | 690   | 690   | 690   | 690   |

|                                            | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   |
|--------------------------------------------|------|------|------|------|--------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat maksimale për pensionet rurale |      |      |      |      | 10,890 | 11,317 | 11,762 | 12,224 |
| Pensioni maksimal i pleqërisë rurale       |      |      |      |      | 10,690 | 11,117 | 11,562 | 12,024 |
| Kompensimi i energjisë elektrike           |      |      |      |      | 200    | 200    | 200    | 200    |

Të ardhurat minimale, mesatare dhe maksimale në vite për pensionistët urbanë dhe ruralë, të pleqërisë




## Dinamika e Invaliditetit

Gjatë vitit 2013 janë deklaruar invalidë për herë të parë, sipas grup-sëmundjeve, gjithsej 7,076 persona. Referuar analizës së të dhënave për invaliditetin rezulton se në vend të parë për invalidizim kanë qenë sëmundjet e Aparatit të Qarkullimit (kardiovaskulare) (Grupi VII), të cilat kanë pësuar rritje nga 24.6% të totalit të invalidëve të rinj, në 26.9%. Më pas janë sëmundjet Tumorale (Grupi II), të cilat kanë shkaktuar invalidizim të lartë tek të sëmurët e prekur nga këto sëmundje, por krahasuar me vitin 2012, ka një ulje të lehtë të personave që përfitojnë pension invaliditeti si pasojë e tyre, nga 17.9% në vitin 2012 në 17.6% në vitin 2013. Përsa i përket invaliditetit të shkaktuar nga sëmundjet e Kockave, Kyçeve, Indit Lidhës (Grupi XIII), ka patur një rritje të lehtë të numrit të personave përfitues, si pasojë e prekjës nga këto sëmundje, nga 9.65% në vitin 2012, në 9.7% në vitin 2013. Lidhur me sëmundjet e Sistemit Nervor Qendror dhe






Shqisave (Grupi VI), është vënë re një ulje e konsiderueshme e numrit të përfituesve të invaliditetit, nga 9.29%, për vitin 2012, në 8.6%, ndërsa përsa i përket Grupit të XVII, ku përfshihen Dëmtimet Traumatike-Helmimet, ka patur shtim të rasteve, që përfitojnë invaliditet, si pasojë e këtyre dëmtimeve nga 8.3% në 8.8%.




Numri i personave që përfitojnë pensione urbane invaliditeti, gjatë vitit 2013, ka ardhur duke u rritur, ndërsa numri i personave që përfitojnë invaliditet sipas vjetërsisë në ish-kooperativat bujqësore ka mbetur pothuajse konstant, duke iu përshtatur edhe strukturës së kontribuesve.



Përsa i përket incidencës së sëmundshmërisë sipas gjinisë, për vitin 2013, konstatohet se ka ndryshime në raportin midis meshkujve dhe femrave. Kështu, më konkretisht, meshkujt kanë numrin më të madh të invaliditetit shkaktuar nga sëmundjet e Aparatit të Qarkullimit (Infarkt, sëmundjet Iskemike të Zemrës, HTA) me rreth 75% të totalit të invaliditetit, ndësa femrat me rreth 25%.

Në lidhje me invaliditetin e shkaktuar nga traumat dhe helmimet (aksidentet automobilistike, përdorimi i drogave, etj), meshkujt përsëri kanë zënë rreth 73% të totalit dhe femrat 27%.

Përsa i përket invaliditetit të shkaktuar nga sëmundjet tumorale, femrat kanë paraqitur incidencë më të lartë krahasuar me meshkujt, duke zënë rreth 55% të totalit të invalidëve të rinj për vitin 2013.




## B. Përfitimet afatshkurtra

Skema e detyrueshme, veç pensioneve, mbron me të ardhura dhe persona të tjerë të siguruar në rastin e pakësimit të tyre si rezultat i:

- Paaftësisë së përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes: periudha e përfitimit zgjat nga 15 ditë deri në 6 muaj, si pasojë e sëmundjes së përgjithshme dhe deri në 1 vit, si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundjeve profesionale. Në këto përfitime përfshihen: të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga sëmundje të përgjithshme dhe të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale. Për vitin 2013 janë trajtuar me paaftësi të përkohëshme në punë nga sëmundje të përgjithshme 1,445 përfitues, nga të cilat 571 në sektorin buxhetor, 311 përfitues në sektorin jobuxhetor dhe 563 përfitues në firmat private;
- Paaftësisë së përkohëshme nga aksidenti në punë dhe sëmundjet profesionale: të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë apo sëmundjet profesionale jepen në momentin kur vërtetohet aksidenti apo sëmundja profesionale, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Për vitin 2013 janë trajtuar me paaftësi të përkohëshme në punë, si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundjeve profesionale 35 përfitues, nga të cilët 5 përfitues në subjektet buxhetore, 8 përfitues në subjekte jobuxhetore dhe 22 përfitues në firmat private;
- Barrë lindjes: përfitimi për barrë lindje i jepet një gruaje të siguruar, lidhur me barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka jo më pak se 12 muaj sigurim, për çdo rast barrë lindjeje. Për vitin 2013 janë trajtuar me përfitim për barrë lindje 12,014 persona, nga të cilat 1,557 në subjektet buxhetore, 889 në subjektet jobuxhetore,

2,796 në firmat private, 706 përfitues të vetëpunësuar në qytet dhe 6,066 përfitues nga të vetëpunësuarit në bujqësi;

- Papunësisë: përfitimet që rrjedhin nga kjo degë sigurimi jepen nga një strukturë e veçantë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.



### C. Përfitimet suplementare

Sigurimi suplementar është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore.

Aktualisht ekzistojnë tri skema:

- Skema e sigurimit shtetëror suplementar;
- Skema e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve;
- Skema e trajtimeve të veçanta.


Qëllimi i skemave të sigurimit suplementar është dhënia e përfitimeve suplementare, si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror për personat që bazuar në ligj deklarohen subjekte të skemave respektive.

Gjatë vitit 2013 janë trajtuar gjithsej me përfitime suplementare rreth 31,175 persona, të cilët, të ndarë sipas skemave paraqiten:

- Në skemën e sigurimit shtetëror suplementar janë trajtuar me përfitime 1,746 persona. Kjo skemë është e detyrueshme përsa i përket pjesëmarrjes në të, për kategoritë e përcaktuara me ligj;
- Në skemën e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve janë trajtuar me përfitime 23,839 persona. Kjo skemë tashmë funksionon sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSH", i ndryshuar, dhe trajton me përfitime suplementare ushtarakët e shërbimit aktiv të strukturave të përcaktuara në të. Skema financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributet e të punësuarve në strukturat ushtarake përkatëse;
- Në skemën e trajtimeve të veçanta, për vitin 2013 janë trajtuar me përfitime 5,590 persona, nga të cilët:
  - ish-punonjës të nëntokës 3,620 persona;
  - trajtime të familjeve përfituese nga Statusi "Dëshmor i Atdheut", 379 familje;
  - ish-punonjës të ndërmarrjeve të industrisë ushtarake, 648 persona;
  - pilotët fluturues në pension, 265 persona;
  - ushtarakët detarë të nëndetësve në pension, 69 persona;
  - si dhe 609 persona që përfitojnë nga Ligji nr. 10139, datë 15.05.2009 "Për pensionet shtetërore

suplementare të punonjësve të Universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”.

Fondet e kësaj skeme përballohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit në nivelin 85.5%, dhe nga kontributet që derdhin personat e përfshirë në të, në nivelin 14.5%.



## KONTRIBUTE



Teuta MUÇO  
Drejtoresh, Drejtoria e Kontributeve

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si një ndër prioritetet e tij ka patur rritjen e numrit të të siguruarve në skemën e sigurimeve shoqërore dhe realizimin e të ardhurave në fushën e kontributeve. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2013, puna institucionale është përqëndruar në arritjen e disa objektivave:

- Realizimi i të ardhurave të programuara për t'u mbledhur nga pagesat e kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe nga personat e siguruar vullnetarisht;
- Bashkëpunimi sistematik me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për nxitjen e plotësimit të planit të të ardhurave nga subjektet në përgjegjësi të organeve tatimore;
- Rritja e numrit të fermerëve në skemën e sigurimeve shoqërore nëpërmjet publikimit të ligjit të faljes së kamatëvonesave për të vetëpunësuarit në bujqësi;
- Rritja e numrit të të siguruarve në skemën e sigurimit vullnetar dhe publikimi i favorizimeve për pagesat paradhënie të kontributeve vjetore;
- Bashkëpunimi me organet tatimore për zbatimin e ligjit të faljes së kamatëvonesave dhe pakësimit të detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitore, i cili i shtriu efektet e tij deri në fund të muajit Dhjetor të vitit 2013;
- Vazhdimi i sistemit dhe hedhjes së kontributeve të paguara nga të vetëpunësuarit në bujqësi në bazën e të dhënave, për periudhën 1993-2013;
- Trajtime për implementimin e programit të informatizuar "Contribution Management Information System", për hedhjen e kontributeve që do të paguheshin për periudhën 1 Janar 2014 e në vazhdim, nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe nga personat e siguruar vullnetarisht.

Ndër arritjet për vitin 2013, në fushën e kontributeve mund të evidentojmë:

- Në fondin e sigurimeve shoqërore, të ardhurat gjithsej nga sigurimet shoqërore të detyrueshme, sigurimi suplementar dhe sigurimi vullnetar, nga 51,161 milionë lekë të programuara janë realizuar 51,452.2 milionë lekë, ose 100.6%, me një tejkalim prej 291.2 milionë lekë. Evidentohet se në vitin 2013, janë mbledhur 2,134 milionë lekë më shumë se vitin e kaluar;
- Plani i të ardhurave, nën përgjegjësinë e realizimit nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nga 2,759 milionë lekë u realizua 3,156.7 milionë lekë, ose 114.4%, me një tejkalim prej 397.7 milionë lekë;
- Plani i të ardhurave, nën përgjegjësinë e realizimit nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nga 48,402 milionë lekë u realizua 48,295.5 milionë lekë, ose 99.8%, me një mosrealizim prej 106.5 milionë lekë.

### Të ardhurat e programuara dhe realizimi i tyre për vitin 2013

|        |                                 | në milionë lekë |          |           |       |
|--------|---------------------------------|-----------------|----------|-----------|-------|
|        |                                 | plan            | fakt     | ndryshimi | %     |
| 1      | Nga subjektet juridike e fizike | 48,402.0        | 48,295.5 | -106.5    | 99.8  |
| 2      | Të vetëpunësuar në bujqësi      | 2,290.0         | 2,519.9  | 229.9     | 110.0 |
| 3      | Sigurimi vullnetar              | 340.0           | 342.4    | 2.4       | 100.7 |
| 4      | Subjekte të ndryshme            | 0.0             | 6.7      | 6.7       |       |
| 5      | Të ardhura të tjera             | 129.0           | 287.7    | 158.7     | 223.0 |
| Totali |                                 | 51,161.0        | 51,452.2 | 291.2     | 100.6 |

### **Për të vetëpunësuarit në bujqësi**

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi, për vitin 2013, nga 2,290 milionë lekë u realizuan 2,519.9 milionë lekë, ose 110%, me një tejkalim prej 229.9 milionë lekësh. Këtu duhet të theksojmë se Ligji nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor" i shtriu efektet deri me datë 31.12.2013, ligj i cili favorizoi edhe të vetëpunësuarit në bujqësi, pasi lejonte pagesat e kontributeve pa kamatëvonesë. Gjithashtu, ky

ligj pati ndikim pozitiv në rritjen e numrit të fermerëve të siguruar dhe në tejkalimin e të ardhurave të programuara nga të vetëpunësuarit në bujqësi për vitin 2013.

Ndërkohë në skemën e sigurimit shoqëror në zonat rurale, gjatë vitit 2013, janë konstatuar dy fenomene negative që kanë influencuar në rënien e numrit të të siguruarve të vetëpunësuar në bujqësi, në krahasim me vitin 2012, si:

- Personat me moshë të re, në zonat rurale, janë më pak të interesuar për t'u siguruar;
- Të gjithë ata persona të cilët kanë plotësuar 35 vjet vjetërsi në punë e ndërpresin sigurimin e tyre deri në mbushjen e moshës për të përfituar pension.



### **Për sigurimin vullnetar**

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve të personave të siguruar vullnetarisht, për vitin 2013, nga 340 milionë lekë u realizuan 342.4 milionë lekë, ose 100.7%, me një tejkalim prej 2,4 milionë lekë.

Gjatë vitit 2013, në funksion të sigurimit vullnetar, është bërë një publicitet i vazhdueshëm si brenda, ashtu dhe jashtë vendit, veçanërisht për emigrantët në Itali. Në këtë kuadër, ka vazhduar bashkëpunimi me disa Patronate në Itali, si "INAS", "CISL", "ACAI", "ACLI", "ENAS-UGL", të cilët kanë punuar për përfshirjen e emigrantëve shqiptarë në skemën e sigurimit vullnetar dhe konfirmimin e periudhave kontributive.

Në mosfunksionimin siç duhet të skemës së sigurimit vullnetar, për vitin 2013, kanë ndikuar disa faktorë, të cilët kanë influencuar në rënien e të ardhurave, në krahasim me të ardhurat e realizuara në vitin 2012, ndër të cilat veçojmë:

Moskthimi i një numri të konsiderueshëm emigrantësh, të përhershëm apo sezonalë, në atdhe;

Emigrantët të cilët kanë ardhur gjatë vitit 2013, janë siguruar vetëm për vitin korent;

Kategori të caktuar personash kanë synuar sigurimin vullnetar, vetëm për të plotësuar 15 vjet sigurim. Në këtë kategori përfshihen edhe emigrantët, të cilët kanë vjetërsi kontributive, në shtetet ku ata janë rezidentë.


### **Ulja e normës kontributive dhe influenza në rritjen e të ardhurave**

Reduktimi i masës së kontributeve për punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit ka ndikuar pozitivisht jo vetëm në rritjen e të ardhurave, por edhe në rritjen e numrit të të punësuarve në subjektet privatë juridikë e fizikë, si dhe të numrit mesatar të kontribuesve për një subjekt.



Të ardhurat nga kontributet dhe norma kontributive në vite

|                                     | 2008   | 2009   | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   |
|-------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat në milionë lekë         | 42,795 | 44,323 | 45,020 | 48,522 | 49,324 | 51,452 |
| Rritja ndaj vitit të mëparshëm në % | 13.2%  | 3.6%   | 1.6%   | 7.8%   | 1.7%   | 4.3%   |
| Norma e kontributit ndaj pagës në % | 29.5   | 26.5   | 24.5   | 24.5   | 24.5   | 24.5   |
|                                     | 13.2%  | 3.6%   | 1.6%   | 7.8%   | 1.7%   | 4.3%   |
|                                     | 2008   | 2009   | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   |
| Të ardhurat në milionë lekë         | 42,795 | 44,323 | 45,020 | 48,522 | 49,324 | 51,452 |
| Norma e kontributit në % ndaj pagës | 29.5   | 26.5   | 24.5   | 24.5   | 24.5   | 24.5   |



## Realizimi i numrit mesatar të kontribuesve

Gjatë vitit 2013 numri mesatar i kontribuesve rezultoi 702,086 nga 651,614 që ishte gjatë vitit 2012, ose 7.7% më i lartë, me 50,472 kontribues më shumë.

|                            | Viti 2013     |                           | viti 2012     | numri i 2013 ndaj     |
|----------------------------|---------------|---------------------------|---------------|-----------------------|
|                            | numër mesatar | në përqindje ndaj totalit | numër mesatar | numrit të 2012 (në %) |
| sipas subjekteve:          | 651,664       | 92.8                      | 603,404       | 108.0                 |
| ndërmarrje buxhetore       | 138,010       | 19.7                      | 138,232       | 99.8                  |
| ndërmarrje jobuxhetore     | 20,029        | 2.9                       | 20,929        | 95.7                  |
| firma private              | 201,270       | 28.7                      | 188,632       | 106.7                 |
| të vetëpunësuar            | 80,050        | 11.4                      | 79,357        | 100.9                 |
| të vetëpunësuar në bujqësi | 205,191       | 29.2                      | 168,513       | 121.8                 |
| vullnetarisht              | 7,114         | 1.0                       | 7,741         | 91.9                  |
| nga shteti                 | 36,928        | 5.3                       | 33,394        | 110.6                 |
| me përfitim afatshkurtër   | 13,494        | 1.9                       | 14,816        | 91.1                  |
| Numri i kontribuesve       | 702,086       | 100.0                     | 651,614       | 107.7                 |

## Kontribues në sektorin urban

Për subjektet publike rezultuan 158,039 kontribues dhe numri mesatar i personave të punësuar në një subjekt publik arriti në 74.3, pak më e ulët kjo shifër, krahasuar me numrin mesatar të personave të punësuar në një subjekt publik, në fund të vitit 2012.

Për subjektet private rezultuan 281,320 kontribues, nga 267,989 kontribues që ishin në vitin 2012 me një rritje prej rreth 5% ose 13,331 kontribues më shumë. Kjo rritje u reflektua edhe në rritjen e numrit mesatar të personave të punësuar në një subjekt privat i cili shkoi në rreth 4 të punësuar, nga 3.5 të punësuar në një subjekt, që ishin në vitin 2012, të ndarë si më poshtë:

- Në subjektet “firma private” rezultuan 201,270 kontribues, nga 188,632 kontribues që ishin në vitin 2012, me një rritje prej rreth 6.7% ose 12,638 kontribues më shumë. Ndërkohë që numri mesatar i personave të punësuar në një firmë private arriti në rreth 13 të punësuar nga 12 të punësuar, që ishin në vitin 2012;
- Në subjektet “të vetëpunësuar” rezultuan 80,050 kontribues, nga 79,357 kontribues që ishin në vitin 2012,




me një rritje prej rreth 1% ose 693 kontribues më shumë. Numri mesatar i të punësuarve në një subjekt të vetëpunësuar arriti në 1.4 persona nga 1.3 të punësuar, që ishin në vitin 2012.

### Kontribues në sektorin e të vetëpunësuarëve në bujqësi

Gjatë vitit 2013 numri i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi, rezultoi në 205,191 kontribues nga 168,513 që ishin në vitin 2012, me një rritje prej rreth 22% ose 36,678 kontribues më shumë. Ndërsa numri fizik i të vetëpunësuarve në bujqësi rezultoi 62,442 persona, nga të cilët 63% femra dhe 37% meshkuj. Të analizuar sipas ndarjes së zonave gjeografike të vendit konstatohet se kanë qenë rreth 74% të vetëpunësuar në bujqësi për zonat fushore dhe rreth 26% të vetëpunësuar në bujqësi për zonat malore. Ndërsa numri i të vetëpunësuarve në bujqësi, të siguruar sipas grupmoshave, për vitin 2013, rezulton si më poshtë:

- Personat deri në moshën 30 vjeç zënë 13% të numrit të përgjithshëm të të siguruarve. Kjo tregon se sigurimi i moshave të reja është në një numër relativisht të vogël dhe në këtë grup predominon sigurimi i grave për përfitimin e barrë lindjes;
- Personat e grupmoshës nga 31-60 vjeç zënë 75% të numrit të përgjithshëm të të siguruarve. Edhe në këtë grup, predominon sigurimi i kontribuesve në vazhdimësi të sigurimit dhe kontribuesve që kërkojnë të plotësojnë periudhën prej 35 vjet të siguruar, që nevojitet për një pension të plotë pleqërie.




Sipas periudhave që kanë siguruar të vetëpunësuarit në bujqësi rezulton se 36.7 % persona janë siguruar për periudha të kaluara dhe për vitin korent, 26.7 % persona janë siguruar vetëm për periudha të kaluara, pa vitin korent dhe 36.6 % persona janë siguruar vetëm për vitin 2013.

### Për personat e siguruar vullnetarisht

Numri mesatar i personave të siguruar vullnetarisht gjatë vitit 2013 rezultoi 7,114 persona dhe krahasuar me vitin 2012 pati ulje me 8.1% ose 627 persona të siguruar vullnetarisht më pak. Ndërsa numri fizik i personave të siguruar vullnetarisht në fund të vitit 2013 pati një rritje me 321 persona, nga 4,484 persona që ishin siguruar vullnetarisht gjatë vitit 2012, në vitin 2013 u siguruan vullnetarisht 4,805 persona. Duke analizuar grupmoshën e personave fizikë të siguruar vullnetarisht, rezulton se:

- Në totalin e numrit fizik të kontribuesve për vitin 2013, kontribuesit brenda vendit kanë zënë rreth 62.4% nga 59.8 % që zinin në vitin 2012 dhe emigrantët kanë zënë rreth 37.6%, nga 40.2 % që zinin në vitin 2012;
- Në totalin e numrit të personave të siguruar, që nga fillimi i skemës së sigurimit vullnetar, grupmoshat 18-30 vjeç përbëjnë 7.1%, grupmosha 31-50 vjeç 45.8% dhe grupmosha mbi 50 vjeç 47.1%.



### Baza e të dhënave për të punësuarit, të vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në bujqësi dhe personat e siguruar vullnetarisht

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kanë bashkëpunuar për kalimin e listëpagesave të subjekteve në bazën e të dhënave të ISSH-së, me qëllim krijimin e historikut kontributiv për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. Si rezultat, gjatë vitit 2013, janë hedhur në serverin e ISSH-së afërsisht 100,000 listëpagesa nga 902,268 që ishin në total. Në këtë kuadër Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë vitit 2013, nisi implementimin e një programi të ri, i cili në vazhdimësi do të ndihmojë në këtë proces, duke rritur shpejtësinë dhe saktësinë e dërgimit të këtyre listëpagesave.

Për krijimin e bazës së të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi, për periudhën 1993 – 2013, ISSH dhe DRSSH-të kanë koordinuar punën duke e ndarë këtë periudhë të dhënash në dy pjesë: në bazën e të dhënave të periudhës 1993 – 2005, në të cilën puna për hedhjen e të dhënave shkoi drejt përfundimit dhe në bazën e të dhënave të periudhës 2006 – 2013, e cila ka përfunduar. Kështu në të dy bazat e të dhënave u bë e mundur hedhja e të dhënave analitike për 583,274 të vetëpunësuar në bujqësi, të cilët kanë qenë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore, gjatë këtyre viteve.

Krahas punës për hedhjen e të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi, ISSH në bashkëpunim me DRSSH-të, gjatë vitit 2013 ka vazhduar punën për hedhjen e pagesave të kontributeve, të personave të siguruar vullnetarisht, në bazën e të dhënave të skemës së sigurimit vullnetar. Si rezultat që nga fillimi i kësaj skeme dhe deri në fund të vitit 2013, në bazë e të dhënave të skemës së sigurimit vullnetar janë regjistruar në total 29,645 persona.

Po kështu, gjatë vitit 2013, janë organizuar disa trajnime dhe takime me specialistët tanë, për t'i paraprirë implementimit të programit të informatizuar "Contribution Management Information System", për hedhjen e kontributeve që do të derdhen që nga 1 Janari i vitit 2014, nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe nga personat e siguruar vullnetarisht.



## ADMINISTRIMI I BURIMEVE TË INFORMACIONIT



Kreshnik BRASHA  
Drejtor, Drejtoria e IT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kuadër të informatizimit të mëtijshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore është fokusuar në vazhdimin e realizimit të disa projekteve dhe detyrave, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm funksionet teknologjike të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shërbimet ndaj klientëve të saj. Mbështetur në këtë strategji zhvillimi, gjatë vitit 2013, është kryer:

- Vazhdimi i punës për hedhjen e kartelave të pensioneve të të gjitha llojeve, si ato urbane dhe rurale, në programin e hedhjes online të dosjeve të pensioneve në kartelat elektronike, i cili e ka bërë më efikas procesin e kontrollit të abuzimeve në përfitimet e pensioneve. Për këtë program është ndërtuar rrjeti i transmetimit on line i të dhënave (data transmission) për DRSSH-të Tiranë, Durrës, Elbasan,

Fier, Lezhë, Vlorë, Shkodër, Berat, Gjirokastrë, Kukës, Korçë, Dibër dhe Degët Rajonale të Sarandës dhe Tropojës e cila është ende në proces. Ecuria e këtij programi deri në fund të viti 2013 ka qenë si në tabelën e mëposhtme:

| DRSSH         | Pleqëri        | Invalidë      | Familjar      | Suplementare  | Totali         |
|---------------|----------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| Berat         | 26.093         | 3.088         | 2.352         | 1.304         | 32.837         |
| Dibër         | 9.606          | 1.659         | 2.035         | 764           | 14.064         |
| Durrës        | 35.616         | 4.575         | 3.177         | 1.823         | 45.191         |
| Elbasan       | 39.876         | 9.035         | 5.305         | 1.560         | 55.776         |
| Fier          | 50.696         | 6.302         | 5.376         | 1.466         | 63.840         |
| Gjirokastrë   | 18.703         | 2.302         | 2.113         | 968           | 24.086         |
| Korçë         | 41.383         | 5.661         | 4.476         | 2.204         | 53.724         |
| Kukës         | 8.012          | 1.969         | 1.779         | 496           | 12.256         |
| Lezhë         | 19.060         | 3.449         | 3.393         | 892           | 26.794         |
| Shkodër       | 36.958         | 4.027         | 4.510         | 1.226         | 46.721         |
| Tiranë        | 96.241         | 11.188        | 8.998         | 13.217        | 129.644        |
| Vlorë         | 26.020         | 2.473         | 2.420         | 1.687         | 32.600         |
| Sarandë       | 12.713         | 1.953         | 1.095         | 744           | 16.505         |
| <b>Totali</b> | <b>420.977</b> | <b>57.681</b> | <b>47.029</b> | <b>28.351</b> | <b>554.038</b> |

Ndërkohë që me anë të këtij programi, është realizuar:

- Hedhja e pensioneve të reja të lidhura deri më 31.12.2013 dhe hedhja e dosjeve stok;
- Azhurnimi i pensioneve të mbyllura;
- Pasqyrimi në kohë reale i rritjes së pensioneve për vitin 2013, me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 "Për rritjen e pensioneve".

Të gjitha të dhënat që lidhen me gjeneralitetin e një personi merren online nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, duke garantuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave dhe kontrollin në kohë reale të tyre. Ky shkëmbim online i të dhënave ka bërë të mundur shmangien e pensioneve me datëlindje të ndryshuar, duke sjellë pastrimin e skemës nga pensionet e pamerituara ose evidentimin e pagesave të dubluara.


- Shtirja dhe implementimi i programit të hedhjes së pensioneve, i cili ka vazhduar me shtirjen e rrjetit data në të gjitha DRSSH-të. Me anë të këtij programi, "web application" të gjitha të dhënat që lidhen me gjeneralitetin e një personi, merren online nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, duke garantuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave dhe kontrollin në kohë reale të tyre. Shkëmbimi online i të dhënave ka bërë të mundur shmangien e përfitimeve të lidhura në mënyrë të padrejtë nga ndryshimet e moshës së përfituesve, si dhe evidentimin e pagesave të dubluara, duke sjellë pastrimin e skemës nga pensionet e pamerituara. Gjatë vitit 2013, nëpërmjet këtij programi, u evidentuan 137 raste të dosjeve të dubluara nëpër Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për verifikimin e të cilave është krijuar në ISSH një komiteti Ad-Hoc, i cili merret me të gjitha procedurat e mëtijshme të këtyre dosjeve;
- Përfundimi i programit të kalkulimit online të përfitimeve, si dhe vënia në punë dhe trajnimi i stafit në dy Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore të Vlorës dhe Fierit, të cilat u përzgjedhën si agjenci pilot. Ky proces, i cili nis në Agjenci me pranimin e kërkesave të aplikuesve, vazhdon më pas me shpërndarjen e kërkesave në formë elektronike në DRSSH-të përkatëse, nga ku bëhet shpërndarja e punës për llogaritjen e pensionit online. Në përfundim të aplikimit të kërkesës në Agjenci, kërkesit me anë të numrit të

identitetit, mund të kontrollojnë llogaritjen e pensionit të tyre online, në faqen e web-it të ISSH-së <http://epensione.iss.gov.al/>. Programi funksionon në web application dhe të dhënat janë të përqëndruara në Serverin qendror të ISSH-së. Informacioni përcillet në kohë reale, ndërkohë që të dhënat e përfituesve merren online nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile. Si rezultat i vënies në funksion të këtij programi, deri në fund të vitit janë pranuar nga Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, Fier 1,746 kërkesa dhe Vlorë 1,160 kërkesa;



- Vazhdimi i implementimit të portalit të pagesave online në pikat paguese të qyteteve Berat, Durrës, Korçë, Kukës dhe në 14 qendra paguese në Tiranë. Ky sistem ka mundësuar realizimin e pagesave në kohë më të shpejtë dhe në mënyrë më efektive. Gjithashtu, gjatë vitit 2013 janë ngarkuar në sistem për pagesa online edhe Rajonet Gjirokastrë, Lezhë, disa pika paguese në Elbasan dhe Shkodër, ndërkohë që shkarkimi dhe kontrolli i pagesave është bërë nga vetë DRSSH-të përkatëse. Deri në fund të vitit 2013 janë kryer në total 1.949.044 pagesa online.

| DRSSH         | Janar          | Shkurt         | Mars           | Prill          | Maj            | Qershor        | Korrik         | Gusht          | Shtator        | Tetor          | Nentor         | Dhjetor        | Totali           |
|---------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------------|
| Berat         | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | 12,764         | 12,851         | 25,615           |
| Durrës        | -              | -              | -              | -              | -              | 26,975         | 27,022         | 27,234         | 27,406         | 27,515         | 27,878         | 28,214         | 192,244          |
| Elbasan       | 18,351         | 18,450         | 18,521         | 18,593         | 18,573         | 18,572         | 18,689         | 18,991         | 19,051         | 19,009         | 18,996         | 18,987         | 224,783          |
| Fier          | 17,967         | 18,067         | 18,103         | 18,142         | 18,234         | 18,279         | 18,280         | 18,507         | 18,466         | 18,512         | 18,552         | 30,999         | 232,108          |
| Korçë         | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | 16,998         | 17,034         | 34,032           |
| Kukës         | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | -              | 6,780          | 6,780            |
| Shkodër       | 22,557         | 22,526         | 22,569         | 22,530         | 22,511         | 22,489         | 22,414         | 22,744         | 22,792         | 22,689         | 22,675         | 22,680         | 271,176          |
| Tiranë        | 37,795         | 37,814         | 37,885         | 37,938         | 38,056         | 68,912         | 69,095         | 69,968         | 75,628         | 76,070         | 81,743         | 103,059        | 733,963          |
| Vlorë         | 18,798         | 18,807         | 18,828         | 18,828         | 18,838         | 18,789         | 18,745         | 18,859         | 18,754         | 18,615         | 18,571         | 21,911         | 228,343          |
| <b>Totali</b> | <b>115,468</b> | <b>115,664</b> | <b>115,906</b> | <b>116,031</b> | <b>116,212</b> | <b>174,016</b> | <b>174,245</b> | <b>176,303</b> | <b>182,097</b> | <b>182,410</b> | <b>218,177</b> | <b>262,515</b> | <b>1,949,044</b> |



## ARKIVI QENDROR I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Vënia në funksion të plotë e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore gjatë vitit 2013, ka qënë një ndër arritjet më të mëdha të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Ky arkiv, i cili u ndërtua me fondet e Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore, në kuadër të kredisë së dhënë për modernizimin e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore, është i veçantë si për ambientet dhe pajisjet, ashtu edhe për volumin e madh të punës që realizon çdo ditë.

I cilësuar si ndër më modernët e llojit të tij në Ballkan, ky objekt u vlerësua dhe nga Banka Botërore si një nga investimet më të suksesshme të saj në Shqipëri. Rëndësia e funksionimit të tij qëndron në arkivimin e dokumentacionit të historikut kontributiv të të gjithë shtetasve, jo vetëm në letër, por edhe në formë dixhitale. Ky proces, i cili ka nisur nëpërmjet grumbullimit, skanimit dhe dixhitalizimit të dokumentacionit të vjetërsisë në punë, ka mundësuar krijimin e arkivës dixhitale me llogaritë individuale kontributive të çdo pjesëmarrësi në sistemin e sigurimeve shoqërore. Gjatë vitit 2013 krahas regjistrave të punës të ish-kooperativave bujqësore, është realizuar dixhitalizimi i pjesës më të madhe të regjistrave të ish-ndërmarrjeve shtetërore, deri në vitin 1994, si dhe është përgatitur dokumentacioni i kontributeve pas vitit 1994. Falë kësaj pune intensive, në Arkivin Qendror të Sigurimeve Shoqërore është bërë e mundur:

- rritja e transparencës ndaj çdo kontribuesi;
- realizimi i një shërbimi të shpejtë dhe cilësor ndaj çdo individi;
- llogaritja automatike e përfitimeve;
- mirëadministrimi i fondeve;
- krijimi i një baze shumë të vlefshme të dhënash.

Megjithëse ndërtimi i godinës së Arkivit Qendror të ISSH-së, përfundoi në vitin 2012, gjatë vitit 2013 u bë e mundur plotësimi me të gjithë infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë informatike, teknologjisë për ruajtjen dhe kontrollin e temperaturës, ventilimin, ndriçimin etj. Ndërkohë u stabilizua struktura organizative e tij, u realizua transporti, marrja në dorëzim, çertifikimi dhe sistemimi në raftet e regjistrave të vjetërsisë në punë të ish-kooperativave bujqësore, si dhe regjistrave të vjetërsisë në punë. Gjendja mjaft e dobët fizike e dokumentacionit të ndërmarrjeve në lidhje me sigurimet shoqërore, fakti që gjendej i shpërndarë në institucione, ndërmarrje, arkiva vendore etj, si dhe mungesa e ambienteve apo gjetja e tyre në ambiente të papërshtatshme për ruajtjen, evidentuan domosdoshmërinë e përsheptimit të grumbullimit, dizinfektimit, marrjes në dorëzim dhe sistemimit të dokumentave. Për realizimin e këtij procesi, gjatë vitit 2013, nisi edhe bar-kodimi i regjistrave themeltarë, i cili ka një rëndësi të veçantë sepse lehtëson mënyrën e identifikimit në një kohë të shkurtër të vendndodhjes së regjistrave në arkivë, si dhe për inventarizimin e tyre. Kjo procedurë ka përfunduar për Rajonet e Kukësit, Dibrës e Beratit, si për regjistrat e ish-kooperativave bujqësore ashtu edhe për regjistrat e subjekteve shtetërore, ndërkohë që janë në proces Rajonet e Durrësit, Elbasanit dhe Korçës.

Si rrjedhojë, deri në fund të vitit 2013, u bë e mundur hedhja e 17,673 regjistrave në total: 8,223 regjistra të ish-kooperativave bujqësore dhe 9,450 regjistra të ish-ndërmarrjeve shtetërore, që përbëjnë rreth 80%





të volumit të punës, që lidhet me dixhitalizimin e regjistrave të vjetërsisë në punë para vitit 1994. Të gjithë këta regjistra kanë kaluar në procesin e skanimit dhe të bashkimit të imazheve me të dhënat e numerizuara të fletëve, që sjell një akses të shpejtë dhe të sigurtë të këtyre të dhënave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2013, u mundësua grumbullimi dhe vendosja në një pjesë të veçantë të Arkivit Qendror, i të gjithë dokumentacionit të vjetërsisë në punë për Rajonin e Tiranës. Ky proces filloi me restaurimin dhe skanimin e 35% të regjistrave të vjetërsisë në punë të ish - ndërmarrjeve shtetërore të Rajonit të Tiranës dhe vazhdoi me dixhitalizimin e rreth 50% të regjistrave të skanuar.

Krahas punës për modernizimin e mëtejshëm të sistemit dhe dixhitalizimit të të dhënave, në Arkivin Qendror të Sigurimeve Shoqërore ka vazhduar normalisht edhe procesi i verifikimit të kërkesave dhe lëshimit të vërtetimeve. Si rezultat janë përpunuar rreth 13,350 kërkesa për individë apo subjekte të ndryshme nga të gjitha rajonet e vendit dhe në përgjigje të këtyre kërkesave, janë lëshuar rreth 10,100 vërtetime.

Gjendja e regjistrave ne vitin 2004



Arkivimi i dokumentave në vitin 2004



Regjistrat e restauruar në vitin 2011



Arkivimi i dokumentave në vitin 2013



Skanimi dhe dixhitalizimi i regjistrave në vitin 2013



Arkivimi i dokumentave në vitin 2013



## AKTIVITETI FINANCIAR



Lindita GJINAJ  
Drejtoresh, Drejtoria e Financës

### 1. Plotësimi i objektivave kryesore financiare

Gjatë vitit 2013, veprimtaria financiare e ISSH-së është fokusuar në:

- Përmirësimin thelbësor të administrimit të sistemit të përfitimeve dhe të pagesave;
- Përditësimin e bazës së të dhënave si në fushën e përfitimeve, ashtu edhe në atë të kontributeve;
- Rritjen e cilësisë së administrimit të fondeve;
- Zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e pensioneve;
- Evidentimin dhe marrjen e masave për minimizimin e risqeve dhe forcimin e kontrollit në përdorimin e fondeve.

### 2. Disa nga aktivitetet dhe rezultatet e ISSH-së, gjatë vitit 2013 në fushën e financës dhe kontrollit kanë qënë:

- Administrimi i 570 mijë përfitimeve aftgjata, 13.5 mijë përfitimeve nga paaftësia e përkohëshme për shkak të sëmundjeve, aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe barrë lindjes, si dhe mbi 31 mijë përfitimeve nga skema suplementare dhe trajtimeve të veçanta. Për këto kategori përfituesish, ISSH-ja transferoi në buxhetet familjare rreth 93.6 miliardë lekë, me një rritje ndaj vitit 2012 në shumën 5,483 milionë lekë ose rreth 6,2% më shumë;
- Arkëtimi në fondin e sigurimeve shoqërore i 51,390 milionë lekëve, nga 51,069 milionë lekë të programuara, me një tejkalim prej 321 milionë lekë ose 100.6%. Gjatë vitit 2013 janë mbledhur 2,147 milionë lekë më shumë se në vitin 2012, me një rritje prej 4.3% dhe kjo ecuri pozitive është evidentuar sidomos në muajin dhjetor 2013;
- Realizimi në masën 114.5% i programit të të ardhurave që u mbledhën nën përgjegjësinë e ISSH-së, me një tejkalim në shumën rreth 400 milionë lekë. Ndërkohë që programi i të ardhurave që u mbledhën nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u realizua në masën 99.8%, me një deficit prej 106 milionë lekësh;
- Financimi i fondit të sigurimeve shoqërore nga Buxheti i Shtetit, për çdo muaj dhe sipas programit të buxhetit të miratuar, në shumën prej 44,326 milionë lekë;
- Respektimi çdo muaj i limiteve të programuara të shpenzimit të fondeve nga ISSH-ja dhe Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ndërkohë që u evidentua një tejkalim i vogël me 0.2%, i cili është mbuluar totalisht nga të ardhurat e realizuara më shumë se programimi. Shpenzimet për vitin 2013 u mbyllën në masën 100.2% ose nga 95,395 milionë lekë të programuara, u realizuan me 95,597 milionë lekë, me një tejkalim prej 202 milionë lekë;
- Zbatimi i treguesve të programuar për shpenzimet administrative, ku programi u realizua në masën 96.3%. Nga 2,049 milionë lekë të programuara, u shpenzuan 1,972 milionë lekë, me një mosrealizim prej 76 milionë lekësh. Kostoja e administrimit të sistemit zuri 2% nga deri në 5% të shpenzimeve që parashikohet si kufi nga ligji i sigurimeve shoqërore;
- Përfundimi i procesit të krijimit të bazës së të dhënave të përfitimeve dhe të sistemit të informatizuar të pagesave të pensioneve. Me anë të këtij procesi gjatë vitit 2013, u futën në sistem mbi 93% e përfitimeve dhe procesi vazhdon intensivisht për përfundimin e tij brenda muajit qershor të vitit 2014;
- Realizimi brenda muajit gusht 2013 të procedurave të rritjes së pensioneve me 4% për pensionet urbane, pensionet suplementare e trajtimet e veçanta financiare dhe me 5% për pensionet rurale, si dhe u bë e mundur që pagesat e tyre të bëhen brenda po këtij muaji;
- Rritja e efektivitetit dhe e forcës së kontrollit në luftën kundër informalitetit në zbatimin e procedurave të caktimit dhe pagimit të përfitimeve, veçanërisht në fushën e pensioneve, si nëpërmjet forcimit të kontrollit të brendshëm operacional, ashtu edhe nëpërmjet zbatimit të programeve informatike në këtë sistem.


Volumi i transfertave në buxhetet familjare për periudhën 2009 – 2013 ka pasur një rritje me rreth 5.5 miliardë lekë mesatarisht çdo vit.



### Ecuria e volumit të transfertave në buxhetet familjare për periudhën 2009 – 2013

|                                         | në milionë lekë |        |        |        |        |
|-----------------------------------------|-----------------|--------|--------|--------|--------|
| Vitet                                   | 2009            | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   |
| Shuma vjetore e transfertave            | 72,339          | 77,975 | 83,664 | 88,141 | 93,624 |
| Rritja në vlerë ndaj vitit të mëparshëm | 7,852           | 5,636  | 5,689  | 4,477  | 5,482  |
| Rritja në %                             | 12.2%           | 7.8%   | 7.3%   | 5.4%   | 6.2%   |

Në mënyrë grafike, për periudhën 2007-2013, transfertat në buxhetet familjare paraqiten si më poshtë:



### 3. Zbatimi i buxhetit të sigurimeve shoqërore

Shpenzimet faktike në total për vitin 2013, krahasuar me programin, u realizuan në masën 100.2 % ose nga 95,395 milionë lekë të programuara, u realizuan 95,597 milionë lekë, me një tejkalim prej rreth 201.6 milionë lekë.

Tabela analitike e shpenzimeve të vitit 2013

|                                                     | në milionë lekë |               |              |              |
|-----------------------------------------------------|-----------------|---------------|--------------|--------------|
| Shpenzimet                                          | Plan            | Fakt          | Ndryshim     | %            |
| Shpenzime për Përfitime                             | 79,333          | 79,632        | 298.9        | 100.4        |
| Sëmundje                                            | 395             | 410           | 14.6         | 103.7        |
| Barrëlindje                                         | 2,304           | 2,334         | 30.0         | 101.3        |
| Pensione                                            | 76,622          | 76,877        | 255.3        | 100.3        |
| për pensione qytet                                  | 63,608          | 63,733        | 125.0        | 100.2        |
| për pensione fshat                                  | 13,014          | 13,144        | 130.3        | 101.0        |
| Aksidente dhe sëmundje profesionale                 | 12              | 11            | -1.0         | 91.6         |
| Shpenzime për Programe të tjera                     | 9,208           | 9,202         | -6.0         | 99.9         |
| Pensione speciale e të posaçme                      | 78              | 77            | -0.9         | 98.8         |
| Shpërblime të invalideve të luftës dhe veteranëve   | 308             | 307           | -0.6         | 99.8         |
| Shtesë nga statusi i invalidit të punës             | 48              | 47            | -0.4         | 99.1         |
| Kompensime                                          | 8,775           | 8,771         | -4.0         | 100.0        |
| I Shpenzime Administrative                          | 2,049           | 1,973         | -76.0        | 96.3         |
| Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli   | 910             | 874           | -36.7        | 96.0         |
| Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore    | 146             | 139           | -7.5         | 94.9         |
| Mallra dhe shërbime të tjera                        | 778             | 758           | -19.7        | 97.5         |
| Për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara | 214             | 202           | -12.5        | 94.2         |
| I' Shpenzime për Skemat Suplementare                | 4,804           | 4,789         | -15.1        | 99.7         |
| <b>Totali i Shpenzimeve</b>                         | <b>95,395</b>   | <b>95,597</b> | <b>201.6</b> | <b>100.2</b> |

Siç konstatohet nga tabela transfera në buxhetet familjare përbën 98% të shpenzimeve totale të ISSH-së. Ndërsa shpenzimet e administrimit janë me një mosrealizim prej 76,3 milionë lekësh ose 96.3%, duke përbërë rreth 2% të shpenzimeve totale.

#### 4. Bilanci “të ardhura – shpenzime” dhe rezultati financiar

Bazuar në realizimin faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve, rezultati financiar i ISSH-së për vitin 2013 rezulton me një tejkalim të të ardhurave ndaj shpenzimeve në shumën 119.5 milionë lekë. Por megjithëse rezultati i hyrjeve dhe shpenzimeve të vitit është i balancuar, volumi i shpenzimeve të sigurimeve shoqërore që financohet nga Buxheti i Shtetit është mjaft i lartë dhe arrin në masën 46.3% të shpenzimeve të përgjithshme të sistemit, pavarësisht se rreth 14.6% e shpenzimeve i takon programeve kompensuese e suplementare të përcaktuara për t’u mbuluar me financime buxhetore.

|                                                         | 2012             | 2013             |
|---------------------------------------------------------|------------------|------------------|
| <b>Të ardhura për degën e pensione (A)</b>              | <b>50,682.0</b>  | <b>54,267.9</b>  |
| Kontribute nga subjektet                                | 43,056.1         | 45,140.4         |
| Qytet                                                   | 41,266.7         | 42,954.9         |
| Fshat                                                   | 1,789.4          | 2,185.5          |
| Kontribute nga Buxheti i Shtetit (shteti si kontribues) | 7,625.9          | 9,127.5          |
| për kategori të ndryshme                                | 2,711.4          | 3,199.7          |
| për subveçione të kontributeve të fermereve             | 4,914.5          | 5,927.8          |
| <b>Shpenzime për degën e pensione (B)</b>               | <b>73,028.0</b>  | <b>78,497.0</b>  |
| Shpenzime për pensione                                  | 71,631.6         | 76,877.0         |
| Qytet                                                   | 58,313.1         | 62,315.9         |
| Fshat                                                   | 13,318.4         | 14,561.1         |
| Shpenzime administrative për pensione                   | 1,396.5          | 1,620.0          |
| Qytet                                                   | 1,136.8          | 1,313.2          |
| Fshat                                                   | 259.6            | 306.8            |
| <b>Diferenca (A - B)</b>                                | <b>-22,346.1</b> | <b>-24,229.1</b> |
| <b>si % e PBB</b>                                       | <b>-1.69</b>     | <b>-1.78</b>     |

Deficiti i sistemit të pensioneve është rritur nga viti në vit. Veçanërisht me deficit të ndjeshëm paraqitet skema e pensioneve të fshatit, ku me të ardhurat e drejtpërdrejta mbulohen vetëm rreth 15% e shpenzimeve, ç’ka dikton domosdoshmërinë e ndërmarrjes së reformave.

#### 5. Auditimi i skemës dhe forcimi i sistemit financiar dhe kontrollit

- ISSH, në kuadër të mirëadministrimit të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shmangies së informalitetit në pagesat e pensioneve, në vite, ka nisur procesin e pastrimit të skemës, i cili ka konsistuar në auditimin e pensioneve dhe përfitimeve të tjera, si dhe në informatizimin e proceseve të punës dhe dixhitalizimit të të dhënave. Përsa i përket ligjshmërisë së përfitimeve që iu lindin qytetarëve nga skema e sigurimeve shoqërore, është konstatuar një dëm ekonomik i konsiderueshëm, i cili llogaritet në rreth 216,294,000 lekë. Sipas të dhënave, vetëm nga Drejtoria e Auditit në ISSH, janë konstatuar rreth 741 dosje me shkelje, nga të cilat pensione me ndryshim datëlindjesh, pra përfitues që kanë hyrë në skemën e përfitimit disa vjet para se t’iu lindë e drejta, janë konstatuar gjithsej 275 raste, me përfitim të padrejtë në masën 98,240,000 lekë. Në këtë kuadër, ISSH ka ndërtuar një sistem informatik të qendëruar dhe sipas standarteve europiane, për informatizimin e të gjitha proceseve të punës. Në këtë sistem janë hedhur dosje të vjetra të pensionit për krijimin e regjistrit kombëtar unik të pensioneve dhe pagimin online të tyre. Falë këtij sistemi, i cili funksionon online me Regjistrin kombëtar të shtetasve, është bërë i mundur kontrolli i datëlindjeve në kohë reale për dosjet e pensioneve në të gjithë vendin, si dhe është mundur konstatimi

i menjëhershëm i rasteve të abuzimeve me datëlindjet ose me gjeneralitetet e tjera. Gjithashtu, hedhja e dosjeve të pensione në një sistem unik, ka nxjerrë në pah rastet e personave që marrin më shumë se një përfitim. Si rezultat, deri në fund të vitit 2013 janë konstatuar 137 raste përfitimesh të dyfishta, për të cilat janë kryer veprimet përkatëse të llogaritjes së dëmit financiar, si dhe denoncimet në prokurori. Nga këto, janë evaduar 100 raste me dëm financiar 70,909,000 lekë, ndërkohë që puna vazhdon të jetë në proces. Gjatë auditimit për vitin 2013, në njësitë e audituara për aktivitetin ekonomik-financiar dhe të përfitimeve afatgjata janë konstatuar gjithsej 390 raste në vlerën 47,145,000 lekë;

- Krahës strukturave dhe procedurës së auditimit ekonomik-financiar në ISSH dhe në çdo DRSSH, funksionon struktura e kontrollit të ligjshmërisë së kryerjes së pagesave. Për vitin 2013 kontrollet e kryera në shërbimet e Postës Shqiptare, si institucion i caktuar për kryerjen e pagesave të pensione, janë konstatuar 2,713 raste të pagesave jo të ligjshme, me një dëm prej 33,016 mijë lekë nga të cilat, pagesa të dubluara 362 raste me dëm 5,597 mijë lekë; pagesa të personave të vdekur 362, me dëm total 6,768 mijë lekë dhe pagesa jashtë afateve të autorizimit në 1,999 raste me një dëm efektiv 20,652 mijë lekë. Nga dëmet e zbuluara gjatë vitit 2013, muaj pas muaji janë arkëtuar 32,440 mijë lekë dhe është në proces vjeljeje shuma prej 570 mijë lekë.

## 6. Gjendja e aktiveve dhe pasiveve

Zbatimi i buxhetit dhe llogaria e ISSH-së realizohet në 15 njësi, nga të cilat 12 janë DRSSH-të, Njësia e Drejtorisë së Arkivit Qendror, Njësia e zbatimit të buxhetit administrativ dhe Njësia e konsolidimit të marrëdhënieve financiare të ISSH-së me Thesarin e Shtetit, Bankën e Shqipërisë, Drejtoritë e Përgjithshme të Bankave të Nivelit të Dytë, si dhe ndërmjet buxhetit qendror dhe buxheteve rajonale. Mbi bazën e pasqyrave dhe raporteve të 15 qendrave të kostos, gjendja e aktiveve më datën 31.12.2013 krahasuar me vitin 2012 paraqitet:

### Gjendja e aktiveve dhe pasiveve

në milionë lekë

| Llogaritë e Aktivit            | Ushtrimi i mbyllur 2013 | Ushtrimi paraardhës 2012 | Ndryshimi      |
|--------------------------------|-------------------------|--------------------------|----------------|
| Aktive të Qëndrueshme          | 1,591,745               | 814,093                  | 777,652        |
| Të patrupëzuara                | 71,033                  | 5,998                    | 65,035         |
| Të trupëzuara                  | 1,520,712               | 808,095                  | 712,617        |
| Aktive Qarkulluese             | 15,353,621              | 14,614,159               | 739,462        |
| Gjendje inventari              | 26,808                  | 27,932                   | -1,124         |
| Kërkesa arkëtimi mbi debitorët | 8,754,716               | 7,170,158                | 1,584,558      |
| Llogaritë financiare           | 6,572,097               | 7,416,069                | -843,972       |
| Rezultati i Ushtrimit          |                         | 933,704                  | -933,704       |
| <b>Totali i Aktivit</b>        | <b>16,945,366</b>       | <b>16,361,956</b>        | <b>583,410</b> |


| Llogaritë e Pasivit     | Ushtrimi i mbyllur 2013 | Ushtrimi paraardhës 2012 | Ndryshimi      |
|-------------------------|-------------------------|--------------------------|----------------|
| Fonde të Veta           | 7,944,591               | 7,139,053                | 805,538        |
| Fonde të veta           | 1,587,259               | 809,608                  | 777,652        |
| Fonde të tjera të veta  | 3,893,117               | 3,893,045                | 73             |
| Rezultati i mbartur     | 2,464,215               | 2,436,401                | 27,814         |
| Detyrime                | 8,399,789               | 7,446,672                | 953,117        |
| Detyrimi afatshkurtër   | 8,399,789               | 7,446,672                | 953,117        |
| Llogari të Tjera        | 479,733                 | 1,776,232                | -1,296,499     |
| Rezultati i Ushtrimit   | 121,254                 | 0                        | 121,254        |
| <b>Totali i Pasivit</b> | <b>16,945,366</b>       | <b>16,361,956</b>        | <b>583,410</b> |

Gjendja e aktivitetit dhe pasivit në fund të viti 2013, krahasuar me vitin 2012, rezulton me një shtesë prej 583.4 milionë lekë.

## 7. Ecuria e treguesve të performancës financiare të sistemit

Përsa i përket qëndrueshmërisë financiare të sistemit dhe ndikimit të tij në buxhetet familjare, me interes është shqyrtimi i ecurisë në vite të disa treguesve analitikë të sistemit, si norma e varësisë, shkalla e mbulimit, norma e zëvendësimit, niveli i përfitimeve ndaj PBB, etj.

- Shkalla e mbulimit shpreh raportin e numrit të kontribuesve ndaj forcave të punës. Duke iu referuar viteve pasi ka ndodhur ulja e normës kontributive, shikohet rritje e shkallës së mbulimit. Ndryshimet ligjore në vitin 2009 për uljen e përqindjes së kontributeve nuk dhanë impaktin e pritshëm për të shtuar ndjeshëm numrin e kontribuesve në raport me forcat e punës. Në fakt në vitin 2010, u konstatua rënie e shkallës së mbulimit krahasuar me vitin 2009, por që sigurisht bart efektin e dy treguesve të këtij raporti kontribues/forca pune.



- Norma e varësisë, që shpreh raportin e përfituesve ndaj kontribuesve të skemës së sigurimeve shoqërore, është përkthyer nga viti në vit deri në 2002, duke filluar me një përmirësim në vitin 2003 e në vazhdim, si rrjedhojë e rënies së ritmit të rritjes së numrit të pensionistëve, si rrjedhojë e reformës për rritjen e moshës dhe rritjes së numrit të kontribuesve. Për vitin 2013 ky koeficient është 0.80.

Norma e zëvendësimit, e cila shpreh raportin midis pensionit dhe pagës për vitet 2012 – 2013 paraqitet:

|                                                         | 2012 | 2013 |
|---------------------------------------------------------|------|------|
| pension mesatar i plotë i pleqërise/pagë mesatare neto  | 49.1 | 51.3 |
| pension mesatar i pleqërise /pagë mesatare neto         | 46.4 | 48.1 |
| pension mesatar i plotë i pleqërise/pagë mesatare bruto | 38.7 | 40.4 |
| pension mesatar i pleqërise /pagë mesatare bruto        | 36.5 | 37.9 |

Gjendja e treguesve të skemës së pensioneve dhe sidomos qëndrueshmëria e brishtë financiare e tij, evidenton domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave për reformimin e sistemit aktual të sigurimeve shoqërore. Reformat që do të ndërmerren, veç ndikimit në qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të sistemit, do të duhet t'i japin zgjidhje të plotë edhe çështjeve të tjera të konstatuara si:

- Vendosjes së elementeve shtytës të rritjes së pjesëmarrjes dhe pagesës së kontributeve, duke eliminuar faktorët që kanë çuar në shpërndarjen e madhësisë së kontributit nga madhësia e pensionit, sidomos në rastet e kontribuesve me pagë mbi mesataren;

- Plotësimi të sistemit të sigurimeve shoqërore me të gjitha kolonat, me qëllim garantimin për të gjithë popullsinë të elementeve të sigurimit shoqëror të harmonizuar, por edhe duke rritur përgjegjësinë e individit për sigurimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për pleqërinë;
- Përmirësimi të formulës dhe rregullave të indeksimit të pensioneve dhe abrogimin e rregullave që çojnë në erozion të shpejtë të shkallës së zëvendësimit;
- Konsolidimi të rezultateve të reformës për uljen e normës së kontributeve dhe mbështetjes së saj me masa të tjera si forcimi i rregullave të deklarimit të punësimit, të deklarimit të pagave, të mbledhjes së borxheve etj, të cilat do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave të sistemit.

## ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE INVESTIMET




Elvin NURIU  
Drejtor i Administrimit  
të Përgjithshëm

Mirëadministrimi i burimeve njerëzore është vlerësuar si një ndër komponentët më të rëndësishëm për realizimin e objektivave institucionale dhe një faktor kyç për të arritur suksesin. Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2013, Instituti i Sigurimeve Shoqërore është fokusuar qartazi në menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me identifikimin e nevojave të personelit, rekrutimin e stafit, përmirësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës, administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe vlerësimit vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse.

Duke vlerësuar këtë aset të rëndësishëm njerëzor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore gjatë vitit 2013 ka pasur si piksynim rritjen e nivelit të kualifikimit dhe orientimit të personelit ekzistues drejt pozicionit të punës në të cilin ato janë kontraktuar, si dhe rekrutimin e vazhdueshëm të elementëve të rinj. Referuar Strukturës Organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, konstatohet se gjatë vitit 2013 numri total i punonjësve ka qenë 1,219 punonjës, duke mos pësuar ndryshim nga viti 2012.

Vlen të evidentohet se gjatë vitit 2013 në strukturën organizative të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, Drejtorisë së Arkivit Qendror, si dhe DRSSH-ve, punonjëset femra kanë zënë rreth 63 % të totalit të përgjithshëm të të punësuarve.

Ndërkohë që për punësimin sipas nivelit arsimor janë ruajtur të njëjtat parametra si në vitin 2012, që do të thotë se rreth 74 % e punonjësve kanë qenë me arsim të lartë, 25 % me arsim të mesëm dhe 1 % me arsim të ulët.



## Trajnimet

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve institucionale, gjatë vitit 2013, janë realizuar aktivitete të ndryshme trajnuese për kualifikimin e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Arkivit Qendror të sigurimeve shoqërore. Ndër to mund të përmendim:

- Trajnim me specialistët e përfitimeve, mbi gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e problemeve që kanë dalë gjatë caktimit, llogaritjes dhe pagesës së përfitimeve, që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në RSH", të ndryshuar;
- Trajnim me pritësit e ALSSH-ve dhe DRSSH-ve për përmirësimin e mëtejshëm të punës në lidhje me klientët tanë;
- Trajnim me inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi, mbi problematikat e kësaj skeme, lidhja midis ligjit dhe zbatimit të tij;
- Trajnim me specialistët e financës për sistemin e FMS dhe punën në sistemin online;
- Trajnim me juristët e DRSSH-ve, në lidhje me konfliktet juridike administrative dhe juridike civile, si dhe marrëdhëniet me zyrat e përmbartimit, në kuadër të privatizimit të tyre.

## Investimet

Gjatë vitit 2013, nëpërmjet programit të investimeve, është synuar që të përmirësohen tërësisht kushtet e punës në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Realizimi me sukses të plotë deri në muajin nëntor 2013 i kontratës për "Rikonstruksionin e Godinës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore", me një vlerë totale prej 44,352,213 lekësh (me tvsh), bëri të mundur shndërrimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në një nga institucionet me standartet më të larta bashkëkohore në vend, duke përmirësuar maksimalisht kushtet e punës për të gjithë stafin.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore para restaurimit



Instituti i Sigurimeve Shoqërore pas restaurimit





Gjithashtu duhet theksuar se gjatë vitit 2013 kanë përfunduar me sukses punimet për rikonstruksionin e DRSSH-së Tiranë, me fonde të vetë ISSH-së, me vlerë kontrate 26,572,800 lekë. Po kështu, me financim të Bankës Botërore, gjatë vitit 2013 përfunduan rikonstruksionet e DRSSH-së Dibër, me vlerë kontrate 17,819,768 lekë (me tvsh), DRSSH-së Kukës, me vlerë 22,131,919 lekë (me tvsh) dhe DRSSH-së Gjirokastrë, me vlerë 20,786,853 lekë (me tvsh).



## INFORMIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN




**Agim BAÇI**  
Drejtor, Drejtoria e Statistikës  
dhe Marrëdhënieve me Publikun

Informimi publik gjatë vitit 2013 ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet Institucionit dhe qytetarëve, si brenda dhe jashtë vendit, duke pasur në fokus të tij publikimin e çdo risije apo materiali informues mbi shërbimet që ofron ISSH-ja, si dhe detyrimet që rrjedhin nga përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore.

Realizimi i procesit të shpërndarjes së informacionit në kohë reale dhe me transparencë nga ISSH-ja tek të gjitha grupet e interesit, nëpërmjet shfrytëzimit të çdo burimi informativ, faqes zyrtare [www.iss.gov.al](http://www.iss.gov.al), njoftimeve, posterave, fletëpalosjeve, si dhe medias vizive e të shkruar, ka qenë ndër detyrat prioritare të Informimit Publik.

Përdorimi me efektivitet i hapësirave mediatike për botimin e një numri të konsiderueshëm të suplementeve informative, realizimit të një sërë emisionesh televizive, si dhe prononcimit me anë të njoftimeve apo deklaratave të vazhdueshme për shtyp të Drejtores së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kanë tërhequr vëmendjen e medias për problematikat e ngritura.

Në shtypin e shkruar, gjatë vitit 2013 janë publikuar rreth 531 artikuj për sigurimet shoqërore, një numër ky më i ulët krahasuar me vitin 2012, Kjo ka ardhur si rrjedhojë e faktit se duke qenë një vit elektoral, vëmendja mediatike në pjesën më të madhe të vitit, ka qenë e fokusuar kryesisht në këtë problematikë.




| Shtypi/Muajt     | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Totali |
|------------------|-------|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--------|
| Gazeta Shqiptare | 4     | 2      | 2    | 4     | 2   | 2       | 6      | 2     | 3       | 3     | 4      | 4       | 38     |
| Shqip            | 4     | 0      | 4    | 7     | 6   | 0       | 3      | 6     | 4       | 2     | 0      | 1       | 37     |
| RD               | 4     | 3      | 5    | 4     | 8   | 8       | 6      | 8     | 1       | 3     | 0      | 1       | 51     |
| Standart         | 6     | 4      | 5    | 8     | 4   | 7       | 3      | 4     | 0       | 6     | 7      | 4       | 58     |
| Panorama         | 2     | 1      | 6    | 4     | 2   | 3       | 7      | 2     | 3       | 2     | 4      | 4       | 40     |
| Metropol         | 4     | 0      | 7    | 7     | 0   | 6       | 7      | 0     | 4       | 4     | 0      | 0       | 39     |
| Telegraf         | 8     | 2      | 8    | 9     | 7   | 6       | 9      | 7     | 9       | 10    | 7      | 4       | 86     |
| 55               | 0     | 0      | 5    | 0     | 2   | 3       | 4      | 2     | 3       | 0     | 0      | 0       | 19     |
| Shekulli         | 2     | 1      | 5    | 8     | 3   | 3       | 3      | 3     | 4       | 3     | 5      | 4       | 44     |
| Mapo             | 2     | 1      | 7    | 0     | 0   | 2       | 4      | 0     | 1       | 1     | 1      | 2       | 21     |
| Dita             | 3     | 1      | 3    | 3     | 4   | 2       | 3      | 4     | 3       | 6     | 7      | 0       | 39     |
| Shqiptarja.com   | 0     | 0      | 1    | 1     | 1   | 0       | 2      | 1     | 2       | 2     | 1      | 0       | 11     |
| Koha jonë        | 2     | 2      | 3    | 3     | 1   | 4       | 3      | 1     | 3       | 3     | 2      | 1       | 28     |
| ZP               | 1     | 0      | 1    | 1     | 0   | 5       | 7      | 0     | 1       | 0     | 0      | 4       | 20     |
| Totali           | 42    | 17     | 62   | 59    | 40  | 51      | 67     | 40    | 41      | 45    | 38     | 29      | 531    |

## Funksionimi i faqes së internetit

Për t'iu përgjigjur kërkesave gjithnjë e në rritje të qytetarëve për krijimin e një sistemi sa më vizibël dhe bashkëkohor, ISSH është fokusuar në pasurimin dhe përditësimin e faqes zyrtare të ISSH-së, [www.iss.gov.al](http://www.iss.gov.al), me të gjitha risitë apo informacionet e domosdoshme, të cilat lidhen direkt me funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore. Për këtë arsye, që nga shtatori i vitit 2013, është vënë në funksionim faqja e riformuar e internetit, struktura e të cilës iu ka krijuar qytetarëve lehtësi në navigimin e saj, si dhe një larmishmëri më të madhe rubrikash, të cilat përmbajnë të gjitha informacionet dhe shërbimet që ne ofrojmë.



Në muajin tetor 2013, në faqen e riformuar të ISSH-së, u realizua hapja e dy rubrikave të rëndësishme online: Pyesni Online dhe Denonco Online, nëpërmjet të cilave iu është dhënë mundësia të gjithë qytetarëve që kërkojnë informacion apo duan të denoncojnë parregullsitë dhe pakënaqësitë, lidhur me funksionimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, ta kryejnë atë në mënyrë elektronike. Këto dy shërbime online kanë krijuar një sërë lehtësirash për qytetarët që jetojnë si jashtë, ashtu edhe brenda vendit, duke shmangur përdorimin e shërbimit postar, ose paraqitjen e tyre personalisht pranë zyrave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pasi për çdo pyetje apo ankesë që ato drejtojnë, stafi ynë iu përgjigjet brenda afatit.

Në rubrikën Pyesni Online, deri në fund të vitit 2013, qytetarët na kanë drejtuar rreth 278 pyetje, në lidhje me sigurimet shoqërore. Këto pyetje paraqesin një tematikë tepër të larmishme, por siç tregohet dhe në grafik, ato i përkasin kryesisht fushës së kontributeve dhe asaj të përfitimeve.



Ndërkohë, në rubrikën Denonco Online janë regjistruar gjithsej 10 ankesa, dhe çdo rast është shqyrtuar me prioritet, që nga verifikimi i nevojshëm e deri në kthimin e përgjigjes tek qytetari.


Ristrukturimi i faqes së internetit në vitin 2013 dhe pasqyrimi në të të çdo aktiviteti, informacioni apo njoftimi, ka sjellë rritjen në mënyrë të ndjeshme të numrit të klikimeve, duke e çuar në 85,325 numrin e vizitorëve. Gjatë vitit 2013 ka pasur rreth 2,028 vizitorë më shumë se në vitin 2012.



Numri më i madh i klikimeve është bërë nga territori shqiptar (72,049), por interes kanë paraqitur për faqen e internetit edhe vizitorë, të cilët ndodhen në shtetet ku punojnë dhe jetojnë më shumë shqiptarë si: Itali, Greqi, SHBA, etj. Nga grafiku i vizitorëve në linjë evidentohet se 36,690 janë vizitorë të rinj, ndërsa 48,635 janë vizitorë që i janë rikthyer faqes së internetit.







Përafrimi i vazhdueshëm i Institucionit tonë me publikun është realizuar edhe nëpërmjet:

- Përmirësimit të cilësisë së posterave dhe fletëpalosjeve sensibilizuese, si dhe shpërndarjes së tyre pranë të gjithë target-grupeve të interesuara dhe në veçanti, tek emigrantët tanë, që jetojnë dhe punojnë në Itali, duke bashkëpunuar me Patronatet e "INAS", CISL, "ACAI", "ACLI", "ENAS-UGL", të cilët kanë kontribuar me asistencën e tyre në përfshirjen e emigrantëve shqiptarë në skemën e sigurimit vullnetar dhe konfirmimin e periudhave kontributive;
- Përdorimit me efektivitet të medias elektronike dhe realizimit të një sërë emisionesh televizive, për propagandimin e të gjitha shërbimeve, përfitimeve apo dhe detyrimeve, të cilat rrjedhin nga përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore;
- Prezantimit të risive institucionale, ndryshimeve në Ligjin për sigurimet shoqërore, si dhe Vendimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, gjatë vitit 2013, nëpërmjet organizimit të disa konferencave për shtyp, me pjesëmarrjen e gazetarëve të medias së shkruar dhe televizive.

[www.issh.gov.al](http://www.issh.gov.al)

# Statistika të Sigurimeve Shoqërore 2013





## Statistika kryesore të sigurimeve shoqërore

| Të ardhura nga kontributet                              | Viti 2013       |              |
|---------------------------------------------------------|-----------------|--------------|
|                                                         | në milionë lekë | ndaj totalit |
| nga skema e detyrueshme                                 | 69,735          | 91.9%        |
| kontribute të personave juridikë e fizikë <sup>*)</sup> | 50,738          | 66.9%        |
| kontribute me destinacion nga Buxheti i Shtetit         | 9,552           | 12.6%        |
| financime me destinacion nga Buxheti i Shtetit          | 9,507           | 12.5%        |
| transferim kontributesh për sigurimin shëndetësor       | -62             | -0.1%        |
| nga skemat suplementare                                 | 6,152           | 8.1%         |
| të ardhura nga kontributet                              | 714             | 0.9%         |
| financime me destinacion nga Buxheti i Shtetit          | 5,438           | 7.2%         |
| <b>Totali i të ardhurave nga kontributet</b>            | <b>75,887</b>   |              |

|                                            |                     |              |
|--------------------------------------------|---------------------|--------------|
| <b>Totali i të ardhurave të ISSH / PBB</b> | <b>në përqindje</b> | <b>5.59%</b> |
|--------------------------------------------|---------------------|--------------|

| Shpenzime                           | Viti 2013       |              |
|-------------------------------------|-----------------|--------------|
|                                     | në milionë lekë | ndaj totalit |
| për skemën e detyrueshme            | 79,632          | 83.3%        |
| për pensione                        | 76,877          | 80.4%        |
| për programet e veçanta të qeverisë | 9,202           | 9.6%         |
| për skemat suplementare             | 4,789           | 5.0%         |
| kosto administrative                | 1,973           | 2.1%         |
| <b>Totali i shpenzimeve</b>         | <b>95,597</b>   |              |

|                        |                     |              |
|------------------------|---------------------|--------------|
| <b>Shpenzime / PBB</b> | <b>në përqindje</b> | <b>7.04%</b> |
|------------------------|---------------------|--------------|

|                          |                     |              |
|--------------------------|---------------------|--------------|
| <b>Subvencioni / PBB</b> | <b>në përqindje</b> | <b>1.45%</b> |
|--------------------------|---------------------|--------------|

|                                                             |             |
|-------------------------------------------------------------|-------------|
| <b>Norma e varësisë së sistemit</b>                         | <b>1.25</b> |
| (numri mesatar i kontribuesve / numri mesatar i pensioneve) |             |

|                                                                        |      |
|------------------------------------------------------------------------|------|
| <b>Shkalla e zëvendësimit</b>                                          |      |
| (pension mesatar pleqërie (i plotë) qytet / pagë mesatare neto qytet)  | 51.3 |
| (pension mesatar pleqërie qytet / pagë mesatare neto qytet)            | 48.1 |
| (pension mesatar pleqërie (i plotë) qytet / pagë mesatare bruto qytet) | 40.4 |
| (pension mesatar pleqërie qytet / pagë mesatare bruto qytet)           | 37.9 |

\* Shënim: Në "Të ardhura nga kontributet" janë përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi.

## Statistika kryesore të sigurimeve shoqërore

### të skemës së detyrueshme

|                                                                   |                              | viti 2013      | viti 2012      | në % ndaj<br>vitit 2012 |
|-------------------------------------------------------------------|------------------------------|----------------|----------------|-------------------------|
| <b>Të ardhurat e Sigurimeve Shoqërore</b>                         | <b>në milionë lekë</b>       | <b>69,735</b>  | <b>65,771</b>  | <b>106.0</b>            |
| kontribute të personave juridikë dhe fizikë <sup>*)</sup>         |                              | 50,738         | 48,604         | 104.6                   |
| kontribute me destinacion nga Buxheti i Shtetit                   |                              | 9,552          | 7,988          | 119.6                   |
| financime me destinacion nga Buxheti i Shtetit                    |                              | 9,507          | 9,259          | 102.7                   |
| transferim kontributësh për sigurimin shëndetësor                 |                              | -62            | -80            | 104.0                   |
| <b>Shpenzimet e Sigurimeve Shoqërore</b>                          | <b>në milionë lekë</b>       | <b>90,807</b>  | <b>84,881</b>  | <b>107.0</b>            |
| shpenzime për përfitime                                           |                              | 79,632         | 74,100         | 107.5                   |
| shpenzime administrative                                          |                              | 1,973          | 1,718          | 114.8                   |
| shpenzime për programe të tjera                                   |                              | 9,202          | 9,062          | 101.5                   |
| <b>Subvencioni</b>                                                | <b>në milionë lekë</b>       | <b>21,073</b>  | <b>19,110</b>  | <b>110.3</b>            |
| <b>Kontribues (numër mesatar)</b>                                 | <b>persona</b>               | <b>702,086</b> | <b>651,614</b> | <b>107.7</b>            |
| sipas subjekteve                                                  |                              | 651,664        | 603,404        | 108.0                   |
| urbanë                                                            |                              | 446,473        | 434,891        | 102.7                   |
| ruralë                                                            |                              | 205,191        | 168,513        | 121.8                   |
| nga shteti                                                        |                              | 36,928         | 33,394         | 110.6                   |
| me përfitim afatshkurtër                                          |                              | 13,494         | 14,816         | 91.1                    |
| <b>Paga mbi të cilën llogaritet kontributi</b>                    | <b>në fund të vitit lekë</b> |                |                |                         |
| minimale                                                          |                              | 19,026         | 18,295         | 104.0                   |
| maksimale                                                         |                              | 95,130         | 91,475         | 104.0                   |
| <b>Masa mujore e kontributit për të vetëpunësuarit</b>            | <b>në fund të vitit lekë</b> | <b>5,708</b>   | <b>5,489</b>   | <b>104.0</b>            |
| <b>Masa mujore e kontributit për të vetëpunësuarit në bujqësi</b> | <b>në fund të vitit lekë</b> |                |                |                         |
| zona fushore                                                      |                              | 2,500          | 2,250          | 111.1                   |
| zona malore                                                       |                              | 1,917          | 1,700          | 112.8                   |
| <b>Masa e kontributit për sigurimin vullnetar</b>                 | <b>në fund të vitit lekë</b> | <b>4,110</b>   | <b>3,952</b>   | <b>104.0</b>            |
| <b>Numri i pensioneve (gjendja në fund)</b>                       | <b>persona</b>               | <b>570,423</b> | <b>554,102</b> | <b>102.9</b>            |
| pensione urbane                                                   |                              | 418,399        | 399,959        | 104.6                   |
| pensione rurale                                                   |                              | 152,024        | 154,143        | 98.6                    |
| <b>Masa e pensionit urban</b>                                     | <b>në fund të vitit lekë</b> |                |                |                         |
| minimal                                                           |                              | 12,024         | 11,562         | 104.0                   |
| maksimal                                                          |                              | 24,048         | 23,123         | 104.0                   |
| <b>Masa e pensionit në fshat</b>                                  | <b>në fund të vitit lekë</b> |                |                |                         |
| minimal                                                           |                              | 8,233          | 7,841          | 105.0                   |
| maksimal                                                          |                              | 12,024         | 11,562         | 104.0                   |


### të skemave suplementare

|                                                      |                        |        |        |       |
|------------------------------------------------------|------------------------|--------|--------|-------|
| <b>Skemat e sigurimit suplementar</b>                | <b>në milionë lekë</b> |        |        |       |
| të ardhura nga kontributet e drejtpërdrejta          |                        | 714    | 720    | 99.3  |
| shpenzime                                            |                        | 4,789  | 4,979  | 96.2  |
| <b>Pjesëmarrës në skemat e sigurimit suplementar</b> | <b>persona</b>         |        |        |       |
| kontribues (numër mesatar)                           |                        | 16,377 | 18,255 | 89.7  |
| përfitues (gjendja në fund)                          |                        | 31,175 | 29,448 | 105.9 |

\* Shënim: Në "Të ardhura nga kontributet" janë përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi.

## Të ardhurat e sigurimeve shoqërore

|                                                                   | milionë lekë<br>viti 2013 | në % ndaj<br>totalit | milionë lekë<br>viti 2012 | në % ndaj<br>vitit 2012 |
|-------------------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------|---------------------------|-------------------------|
| <b>I Kontribute të personave juridikë dhe fizikë<sup>1)</sup></b> | <b>50,312</b>             | <b>72.1</b>          | <b>48,098</b>             | <b>104.6</b>            |
| nga subjektet juridike e fizike                                   | 47,588                    | 68.2                 | 45,731                    | 104.1                   |
| nga të vetëpunësuarit në bujqësi                                  | 2,382                     | 3.4                  | 2,009                     | 118.6                   |
| nga sigurimi vullnetar                                            | 342                       | 0.5                  | 358                       | 95.7                    |
| <b>II Të ardhura të tjera</b>                                     | <b>426</b>                | <b>0.6</b>           | <b>506</b>                | <b>84.2</b>             |
| <b>III Kontribute me destinacion nga Buxheti i Shtetit</b>        | <b>9,552</b>              | <b>13.7</b>          | <b>7,988</b>              | <b>119.6</b>            |
| për ushtarët                                                      |                           | 0.0                  | 25                        | 0.0                     |
| për personat që marrin pagesë papunësie                           | 667                       | 1.0                  | 691                       | 96.6                    |
| për personat që marrin pagesë kalimtare                           | 60                        | 0.1                  | 25                        | 238.0                   |
| për ushtarakët në reformë                                         | 1,759                     | 2.5                  | 1,635                     | 107.6                   |
| për policët në reformë <sup>2)</sup>                              | 195                       | 0.3                  |                           |                         |
| diferenca për të vetëpunësuarit në bujqësi                        | 6,312                     | 9.1                  | 5,233                     | 120.6                   |
| për punonjës të industrisë ushtarake                              | 215                       | 0.3                  | 208                       | 103.2                   |
| për gra të pensionuara për vitin raportues                        | 345                       | 0.5                  | 171                       | 201.7                   |
| <b>IV Financime me destinacion nga Buxheti i Shtetit</b>          | <b>9,507</b>              | <b>13.6</b>          | <b>9,259</b>              | <b>102.7</b>            |
| kompensime çmimesh                                                | 4,006                     | 5.7                  | 3,852                     | 104.0                   |
| pensione të posaçme shtetërore                                    | 94                        | 0.1                  | 89                        | 106.0                   |
| shpërblime mbi pensione për veteranët                             | 407                       | 0.6                  | 419                       | 97.3                    |
| shtesë nga statusi i invalidit të punës                           | 58                        | 0.1                  | 52                        | 111.6                   |
| kompensim për pensione                                            | 4,941                     | 7.1                  | 4,848                     | 101.9                   |
| <b>SHUMA (I+II+III+IV)</b>                                        | <b>69,797</b>             |                      | <b>65,851</b>             | <b>106.0</b>            |
| <b>V Transferime kontributesh</b>                                 | <b>62</b>                 | <b>0.1</b>           | <b>80</b>                 | <b>77.6</b>             |
| për sigurimin shëndetësor                                         | 62                        | 0.1                  | 80                        | 77.6                    |
| <b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË ISSH</b>                              | <b>69,735</b>             |                      | <b>65,771</b>             | <b>106.0</b>            |




Shënim: 1. Në "Kontribute të personave juridikë e fizikë" janë përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi.

2. Kontributet nga Buxheti i Shtetit për "ushtarakë në reformë" dhe "policë në reformë" deri në vitin 2012 janë evidentuar së bashku si një kategori, nga viti 2013 evidentohen të ndarë.


## Shpenzimet e sigurimeve shoqërore

|                                                          | milionë lekë<br>viti 2013 | në % ndaj<br>totalit | milionë lekë<br>viti 2012 | në % ndaj<br>vitit 2012 |
|----------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------|---------------------------|-------------------------|
| <b>I Shpenzime për përfitime</b>                         | <b>79,632</b>             | <b>87.7</b>          | <b>74,100</b>             | <b>107.5</b>            |
| paafësi e përkohshme                                     | 410                       | 0.5                  | 381                       | 107.5                   |
| barrë lindje                                             | 2,334                     | 2.6                  | 2,076                     | 112.4                   |
| pensione                                                 | 76,877                    | 84.7                 | 71,632                    | 107.3                   |
| aksidente dhe sëmundje profesionale                      | 11                        | 0.0                  | 11                        | 98.8                    |
| <b>II Shpenzime administrative</b>                       | <b>1,973</b>              | <b>2.2</b>           | <b>1,718</b>              | <b>114.8</b>            |
| shpenzime operative                                      | 1,771                     | 2.0                  | 1,683                     | 105.2                   |
| investime                                                | 202                       | 0.2                  | 35                        | 573.3                   |
| <b>III Shpenzime për programe të veçanta të qeverisë</b> | <b>9,202</b>              | <b>10.1</b>          | <b>9,062</b>              | <b>101.5</b>            |
| kompensime çmimesh                                       | 8,771                     | 9.7                  | 8,572                     | 102.3                   |
| pensione të posaçme shtetërore                           | 77                        | 0.1                  | 81                        | 94.2                    |
| shpërblime mbi pensione për veteranët                    | 307                       | 0.3                  | 363                       | 84.6                    |
| shtesë nga statusi i invalidit të punës                  | 47                        | 0.1                  | 45                        | 104.0                   |
| <b>TOTALI I SHPENZIMEVE TË ISSH</b>                      | <b>90,807</b>             |                      | <b>84,881</b>             | <b>106.983</b>          |
| <b>SUBVENCIONI</b>                                       | <b>21,073</b>             |                      | <b>19,110</b>             | <b>110.3</b>            |




## Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta të sigurimeve shoqërore në vite

|                                                                  | 2007          | 2008          | 2009          | 2010          | 2011          | 2012          | 2013          |
|------------------------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| milionë lekë                                                     |               |               |               |               |               |               |               |
| <b>Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta<sup>*)</sup></b> | <b>37,664</b> | <b>42,561</b> | <b>44,038</b> | <b>44,658</b> | <b>47,879</b> | <b>48,604</b> | <b>50,738</b> |
| nga subjektet juridike e fizike                                  | 34,705        | 39,749        | 40,998        | 41,484        | 44,537        | 45,731        | 47,588        |
| nga të vetëpunësuarit në bujqësi                                 | 2,509         | 2,160         | 2,344         | 2,349         | 2,538         | 2,009         | 2,382         |
| nga sigurimi vullnetar                                           | 312           | 310           | 370           | 369           | 377           | 358           | 342           |
| nga të ardhurat e tjera                                          | 137           | 342           | 327           | 457           | 426           | 506           | 426           |



## Shpenzimet e sigurimeve shoqërore në vite

|                                          | 2007          | 2008          | 2009          | 2010          | 2011          | 2012          | 2013          |
|------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| milionë lekë                             |               |               |               |               |               |               |               |
| <b>Shpenzimet e sigurimeve shoqërore</b> | <b>58,132</b> | <b>62,909</b> | <b>70,540</b> | <b>76,010</b> | <b>80,428</b> | <b>84,881</b> | <b>90,807</b> |
| Shpenzime për përfitime                  | 49,059        | 53,697        | 60,766        | 65,692        | 69,737        | 74,100        | 79,632        |
| nga këto shpenzimet për pensione         | 47,970        | 52,422        | 59,240        | 63,785        | 67,471        | 71,632        | 76,877        |
| Shpenzime për programe të veçanta        | 7,962         | 7,876         | 8,369         | 8,838         | 9,038         | 9,062         | 9,202         |
| Shpenzime administrative                 | 1,111         | 1,336         | 1,406         | 1,480         | 1,653         | 1,718         | 1,973         |



\* Shënim: Në "Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta" janë përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi.


## Kontribues

Treguesi "kontribues në muajin ....." bazohet në kontributin e derdhur, pagesa e të cilit është kryer gjatë muajit përkatës. Kontributi i derdhur gjatë kësaj periudhe mund të mbulojë edhe muaj të kaluar.

Treguesi "kontribues në vitin ....." bazohet në kontributin e derdhur, pagesa e të cilit është kryer gjatë vitit përkatës. Ky kontribut mund të mbulojë edhe periudha të kaluara.

Treguesi "kontribues në vitin.....", llogaritet duke mbledhur treguesin "kontribues në muajin ....." për të 12 muajt e vitit dhe duke e pjesëtuar këtë shumë me 12.

|                                             | numër mesatar<br>viti 2013 | në % ndaj<br>totalit | numër mesatar<br>viti 2012 | në % ndaj<br>vitit 2012 |
|---------------------------------------------|----------------------------|----------------------|----------------------------|-------------------------|
| <b>sipas subjekteve:</b>                    | <b>651,664</b>             | <b>92.8</b>          | <b>603,404</b>             | <b>108.0</b>            |
| (1) ndërmarrje buxhetore                    | 138,010                    | 19.7                 | 138,232                    | 99.8                    |
| (2) ndërmarrje jobuxhetore                  | 20,029                     | 2.9                  | 20,929                     | 95.7                    |
| (3) firma private                           | 201,270                    | 28.7                 | 188,632                    | 106.7                   |
| (4) të vetëpunësuar                         | 80,050                     | 11.4                 | 79,357                     | 100.9                   |
| (5) të vetëpunësuar në bujqësi              | 205,191                    | 29.2                 | 168,513                    | 121.8                   |
| (6) vullnetarisht                           | 7,114                      | 1.0                  | 7,741                      | 91.9                    |
| <b>(7) nga shteti</b>                       | <b>36,928</b>              | <b>5.3</b>           | <b>33,394</b>              | <b>110.6</b>            |
| të papunë që përfitojnë pagesë papunësie    | 13,003                     | 1.9                  | 13,973                     | 93.1                    |
| persona në pagesë kalimtare                 | 138                        | 0.0                  | 135                        | 102.0                   |
| ushtarakë në reformë                        | 10,661                     | 1.5                  | 10,657                     | 100.0                   |
| policë në reformë <sup>*)</sup>             | 1,624                      | 0.2                  |                            |                         |
| punonjës të nëntokës                        | 3,659                      | 0.5                  | 3,696                      | 99.0                    |
| punonjës të industrisë ushtarake            | 687                        | 0.1                  | 745                        | 92.3                    |
| gra të pensionuara për vitin 2013           | 7,156                      | 1.0                  | 3,682                      | 194.3                   |
| <b>(8) me përfitim afatshkurtër:</b>        | <b>13,494</b>              | <b>1.9</b>           | <b>14,816</b>              | <b>91.1</b>             |
| paaftësi e përkohshme mbi ditën e 14-të     | 1,445                      | 0.2                  | 2,779                      | 52.0                    |
| barrëllindje                                | 12,014                     | 1.7                  | 11,990                     | 100.2                   |
| paaftësi nga aksidentet në punë             | 35                         | 0.0                  | 47                         | 73.9                    |
| <b>Numri i kontribuesve urbanë në total</b> | <b>496,895</b>             | <b>70.8</b>          | <b>483,101</b>             | <b>102.9</b>            |
| <b>Numri i kontribuesve ruralë</b>          | <b>205,191</b>             | <b>29.2</b>          | <b>168,513</b>             | <b>121.8</b>            |
| <b>Numri i kontribuesve</b>                 | <b>702,086</b>             |                      | <b>651,614</b>             | <b>107.7</b>            |



\* Shënim: Kontribuesit nga Buxheti i Shtetit "ushtarakë në reformë" dhe "policë në reformë" deri në vitin 2012 janë evidentuar së bashku si një kategori, në vitin 2013 evidentohen të ndarë.



## Kontribues të sigurimeve shoqërore në vite

numër mesatar

|                                          | 2007           | 2008           | 2009           | 2010           | 2011           | 2012           | 2013           |
|------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>Kontribues</b>                        | <b>678,712</b> | <b>739,773</b> | <b>734,269</b> | <b>694,514</b> | <b>735,448</b> | <b>651,614</b> | <b>702,086</b> |
| <b>sipas subjekteve:</b>                 | <b>618,726</b> | <b>685,643</b> | <b>684,585</b> | <b>651,779</b> | <b>692,110</b> | <b>603,404</b> | <b>651,664</b> |
| publike                                  | 163,267        | 162,562        | 158,033        | 155,124        | 161,164        | 159,161        | 158,039        |
| firma private                            | 125,470        | 142,227        | 158,785        | 170,121        | 182,358        | 188,632        | 201,270        |
| të vetëpunësuar                          | 66,632         | 75,999         | 64,200         | 65,260         | 78,998         | 79,357         | 80,050         |
| të vetëpunësuar në bujqësi <sup>1)</sup> | 255,065        | 297,036        | 294,783        | 252,604        | 261,097        | 168,513        | 205,191        |
| vullnetarisht <sup>1)</sup>              | 8,292          | 7,819          | 8,784          | 8,670          | 8,493          | 7,741          | 7,114          |
| <b>nga shteti:</b>                       | <b>34,410</b>  | <b>32,425</b>  | <b>30,269</b>  | <b>29,825</b>  | <b>27,669</b>  | <b>33,394</b>  | <b>36,928</b>  |
| ushtarë                                  | 5,127          | 3,443          | 2,393          | 1,008          | 780            | 506            |                |
| të papunë që përfitojnë pagesë papunësie | 10,363         | 8,851          | 10,041         | 9,950          | 8,900          | 13,973         | 13,003         |
| persona në pagesë kalimtare              | 215            | 215            | 41             | 107            | 108            | 135            | 138            |
| ushtarakë në reformë                     | 11,876         | 13,872         | 10,108         | 9,597          | 9,944          | 10,657         | 10,661         |
| policë në reformë <sup>2)</sup>          |                |                |                |                |                | 0              | 1,624          |
| punonjës të nëntokës                     | 5,189          | 3,842          | 3,791          | 3,717          | 3,751          | 3,696          | 3,659          |
| punonjës të industrisë ushtarake         | 873            | 852            | 835            | 809            | 774            | 745            | 687            |
| gra të pensionuara për vitin raportues   | 767            | 1,350          | 3,059          | 4,638          | 3,413          | 3,682          | 7,156          |
| <b>me përfitim afatshkurtër:</b>         | <b>25,576</b>  | <b>21,705</b>  | <b>19,415</b>  | <b>12,910</b>  | <b>15,669</b>  | <b>14,816</b>  | <b>13,494</b>  |
| paafësi e përkohshme mbi ditën e 14-të   | 6,084          | 5,223          | 4,350          | 3,314          | 3,821          | 2,779          | 1,445          |
| barrë lindje                             | 19,407         | 16,368         | 15,001         | 9,554          | 11,791         | 11,990         | 12,014         |
| paafësi nga aksidentet në punë           | 85             | 114            | 64             | 43             | 57             | 47             | 35             |
| <b>Kontribues urbanë në total</b>        | <b>423,647</b> | <b>442,737</b> | <b>439,486</b> | <b>441,910</b> | <b>474,351</b> | <b>483,101</b> | <b>496,895</b> |
| <b>Kontribues ruralë</b>                 | <b>255,065</b> | <b>297,036</b> | <b>294,783</b> | <b>252,604</b> | <b>261,097</b> | <b>168,513</b> | <b>205,191</b> |



Shënim: 1. Numri i të vetëpunësuarve në bujqësi në disa vite është i lartë, për shkak të faljes së kamatëvonesave dhe krijimit të mundësisë për blerjen e periudhave që nga viti 1994.

Numri i të vetëpunësuarve në bujqësi dhe kontribuesit vullnetarë janë numëruar për të gjitha periudhat që kanë paguar.

Ulje-ngritjet e numrit të të vetëpunësuarve në bujqësi ndër vite janë të konsiderueshme dhe ndikojnë në numrin total të kontribuesve.

2. Kontribuesit nga Buxheti i Shtetit për "ushtarakë në reformë" dhe "policë në reformë" deri në vitin 2012 janë evidentuar së bashku si një kategori, nga viti 2013 evidentohen të ndarë.

## Kontribues të subjekteve për çdo Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore

### kontribues urbanë

#### numër mesatar


|              |                |
|--------------|----------------|
| Berat        | 16,171         |
| Peshkopi     | 10,253         |
| Durrës       | 37,829         |
| Elbasan      | 24,029         |
| Fier         | 28,523         |
| Gjirokastrë  | 10,027         |
| Korçë        | 20,075         |
| Kukës        | 6,016          |
| Lezhë        | 12,336         |
| Shkodër      | 23,154         |
| Tiranë       | 233,631        |
| Vlorë        | 24,429         |
| <b>TOTAL</b> | <b>446,473</b> |

### kontribues ruralë


#### numër mesatar

|              |                |
|--------------|----------------|
| Berat        | 12,979         |
| Peshkopi     | 6,866          |
| Durrës       | 10,733         |
| Elbasan      | 21,535         |
| Fier         | 28,397         |
| Gjirokastrë  | 14,811         |
| Korçë        | 22,774         |
| Kukës        | 7,568          |
| Lezhë        | 15,822         |
| Shkodër      | 21,248         |
| Tiranë       | 17,536         |
| Vlorë        | 24,922         |
| <b>TOTAL</b> | <b>205,191</b> |

Numri mesatar i kontribuesve urbanë të subjekteve sipas DRSSH



Numri mesatar i kontribuesve ruralë sipas DRSSH



## Mbi të vetëpunësuarit në bujqësi

kontributi vjetor i mbledhur sipas zonave\*) në mijë lekë


|               |                  |
|---------------|------------------|
| fushore       | 457,411          |
| malore        | 1,924,274        |
| <b>totali</b> | <b>2,381,684</b> |

kontribues sipas zonave


vite - njerëz - kontribute

|               |                |
|---------------|----------------|
| fushore       | 43,028         |
| malore        | 162,163        |
| <b>totali</b> | <b>205,191</b> |


Kontributi i të vetëpunësuarve në bujqësi sipas zonave



Kontribues për të vetëpunësuarit në bujqësi sipas zonave



Kontribues të vetëpunësuar në bujqësi sipas DRSSH (në përqindje ndaj totalit)



Kontributi i të vetëpunësuarve në bujqësi sipas DRSSH (në përqindje ndaj totalit)



\* Shënim: Në "Të ardhura nga kontributet" janë përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi.

## Sigurimi vullnetar



Sigurimi Vullnetar është parashikuar në ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe ju ofrohet të gjithë shtetasve shqiptarë me moshë 18 vjeç e lart.

Nuk mund të sigurohen vullnetarisht: personat e vetëpunësuar në bujqësi, shtetasit jo shqiptarë si dhe ata persona të cilëve ju ka lindur e drejta për përfitim.



Kundrejt kontributeve të paguara të gjithë personat e interesuar mund të bëjnë mbulim të periudhave të kaluara duke filluar nga 01.10.1993 e në vazhdim.

|                                    | kontribues<br>numër fizik | kontribues<br>vite - njerëz - kontribute | kontribute<br>milione lekë |
|------------------------------------|---------------------------|------------------------------------------|----------------------------|
| <b>Kontribues &amp; Kontribute</b> | 4,805                     | 7,114                                    | 342                        |
| nga kontribues të rinj             | 1,694                     | 3,408                                    | 164                        |
| nga kontribues në vazhdim          | 3,111                     | 3,707                                    | 178                        |
| <b>totali</b>                      | <b>4,805</b>              | <b>7,114</b>                             | <b>342</b>                 |
| nga kontribues brenda vendit       | 2,996                     | 3,672                                    | 177                        |
| nga kontribues jashtë vendit       | 1,809                     | 3,442                                    | 166                        |
| <b>totali</b>                      | <b>4,805</b>              | <b>7,114</b>                             | <b>342</b>                 |

Personat që kanë derdhur kontribut për sigurim vullnetar gjatë kësaj periudhe grupohen në dy mënyra:



Marrëveshjet e sigurimit vullnetar të lidhura që nga fillimi i skemës grupohen në dy mënyra:




## Pensionet urbane

**PENSIONE URBANE** janë:

- \* pensionet e mbartura të të gjitha kategorive, të caktuara sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 "Për Sigurimet Shoqërore Shtetërore në RPSSH", për personat që kanë qenë në marrëdhënie pune me shtetin,
- \* pensionet e të gjitha kategorive, të caktuara sipas Ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të nenit 96.


### PENSIONE URBANE

|                                                   | gjendja në fund të vitit 2013 |                | në % ndaj totalit | gjendja në fund të vitit 2012 | në % ndaj vitit 2012 |
|---------------------------------------------------|-------------------------------|----------------|-------------------|-------------------------------|----------------------|
|                                                   | totali                        | femra          |                   |                               |                      |
| (1) <b>pensione pleqërie gjithsej</b>             | <b>311,382</b>                | <b>150,402</b> | <b>74.4</b>       | <b>296,076</b>                | <b>105.2</b>         |
| pleqëri e plotë                                   | 243,608                       | 116,475        | 58.2              | 238,612                       | 102.1                |
| pleqëri e pjesshme                                | 64,906                        | 33,263         | 15.5              | 55,109                        | 117.8                |
| të reduktuar                                      | 2,364                         | 635            | 0.6               | 1,846                         | 128.1                |
| vjetërsi shërbimi                                 | 504                           | 29             | 0.1               | 509                           | 99.0                 |
| (2) <b>pensione invaliditeti gjithsej</b>         | <b>59,241</b>                 | <b>22,934</b>  | <b>14.2</b>       | <b>55,245</b>                 | <b>107.2</b>         |
| <b>nga sëmundje të përgjithshme</b>               | <b>56,492</b>                 | <b>22,405</b>  | <b>13.5</b>       | <b>52,466</b>                 | <b>107.7</b>         |
| të përhershëm                                     | 3,682                         | 1,297          | 0.9               | 3,466                         | 106.2                |
